



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:
“Pedagogji” me profile: “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim
Arsimi”
Universiteti Privat “Albanian University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Pranvera (Puka) Kraja

Dr. Matilda Likaj

Nëntor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master Profesional në “Pedagogji” me profile: “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”**

1	IAL aplikues:	Albanian University
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Pedagogji” me profile: “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 89, datë 10.02.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS Nr. 627, datë 20.10.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	5 PAE / 5PAK
18	Numri i studentëve:	20 studentë “Mësuesi në Arsimin fillor” 17 studentë “Menaxhim Arsimi”
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profile: “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes, i Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në Institucionin e Arsimit të Lartë Universiteti Privat “Albanian University”. Ky program studimi është hapur me dokumentin e licencimit me Urdhër MASH Nr. 89, datë 10.02.2010 me emërtimin Master Profesional në “Pedagogji” me profil 1. “Didaktikë” dhe 2. “Menaxhim Arsimi”. Me Urdhër të MAS, Nr. 627, datë 20.10.2022 u bë riorganizimi i këtij programi studimi, sipas rekomandimeve nga Bordi i Akreditimit, duke marrë emërtimin e ri Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”.

Ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe, me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike një vjeçare, përmban 60 ETCS dhe i përket nivelit 7 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kurrikula e programit është e organizuar në lëndë dhe e strukturuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Emërtimi i diplomës është Diplomë e ciklit të dytë “Master Profesional në “Pedagogji” me profile “Mësues i Arsimit Fillor” dhe “Menaxhim arsimi”. Ky program studimi është në përputhje të plotë me strategjinë dhe politikat e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë e duhura akademike që i formojnë ata si profesionistë në profilin e mësuesisë dhe menaxhimit të sistemit arsimor.

Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes që ofron këtë program studimi, përbëhet nga një staf prej 31 pedagogësh gjithsej, prej të cilëve 9 pedagogë PAE dhe 22 pedagogë PAK, të kualifikuar me tituj dhe më grada shkencore sipas dispozitave ligjore. Raporti i pedagogëve PAE/PAK të angazhuar në programin e studimit që po vlerësojmë, është 5 me 5. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka nënshkruar marrëveshje me institucione të shumta për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale të studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2022-2023 për programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profile:

1. “Mësuesi në Arsim Fillor” është 20 studentë (18 + 2 të transferuar), dhe
2. “Menaxhim Arsimi” është 17 studentë (16 + 1 të transferuar)

Ky program studimi i riorganizuar me Urdhër të MAS, Nr. 627, datë 20.10.2022, i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm për herë të parë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” të Fakultetit të Shkencave Shoqërore në “Albanian University”, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ). Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim profesional, të pavarur dhe objektiv, të bazuar në tregues real dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, mbi të cilin do të ngrihet gjykimi i Bordit të Akreditimit të ASCAL për akreditimin e tij.


ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm: Dr. Pranvera Kraja (Puka) dhe Dr. Matilda Likaj, për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga AU, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar këtë raport. Koordinator teknik nga ASCAL në këtë vlerësim, ka qenë Msc. Anilda Beqiraj. GVJ e nisi punën në gusht të vitit 2022, në komunikim të përbashkët për përcaktimin e detyrave kryesore që do të realizoheshin gjatë procesit të vlerësimit. Në bashkërendim midis dy ekspertëve të jashtëm të vlerësimit dhe stafit të ASCAL u përcaktuan edhe datat e vizitave, të cilat u realizuan me 11 dhe 12 shtator 2023 në mjediset e “Albanian University”.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi, u mbështet mbi këtë dokumentacion bazë:

- Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”,
- “Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë” miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021,
- “Raporti i Vlerësimit të Brendshëm” (Qershor, 2023),
- Dosja me dispozitat normative, aktet dhe dëshmitë e ngarkuar nga IAL në e-ASCAL, dhe informacioni i publikuar në faqen web të IAL-së.
- Të dhëna të tjera të siguruara nga vizita në institucion.

Gjatë vizitave në institucion, GVJ, zhvilloi në ditën e parë takime me: Dekanin e Fakultetit të Shkencave Shoqërore (FSHSH), Përgjegjësën e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes (DEA), Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), stafin e programit në proces akreditimi, Drejtorinë e Programeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në ditën e dytë u zhvilluan takime me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike, Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Sektorit të Kërkimit shkencor dhe Projekteve, Sekretarinë mësimore dhe Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët, me studentë të këtij program studimi si dhe u vizituan ambientet e AU-së, sallat e leksioneve, laboratorët dhe biblioteka. Gjatë gjithë këtij procesi vlerësimi ka pasur një bashkëpunim korrekt dhe mirëkuptues ndërmjet antarëve të GVJ-së dhe gjithë stafit të “Albanian University”.

Mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, si dhe nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB dhe evidencat, është hartuar ky raport i vlerësimit të jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Pedagogji” me profil . “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</p> <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” organizohet nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore nën përgjegjësinë e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes të Universitetit “Albanian University” (Evidenca II.2, neni 3). Përmes këtij program studimi, Albanian University, synon kualifikimin e mëtijshëm të studentëve në fushën e mësuesisë dhe menaxhimit arsimor dhe që të kontribuojnë në mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare të vendit. Ky program i nivelit të dytë, synon t’i pajisë studentët me njohuri të posaçme në fushën e mësuesisë me qëllim që të jenë konkures dhe të pozicionohen lehtë në tregun e punës.</p> <p>Rezulton se ky program studimi mbështetet në dokumentet rregullatore të tij, sipas të cilëve “Arsimimi organizohet i koordinuar në përputhje me kërkesat e zhvillimit kombëtar dhe në bashkërendim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit” dhe synon “të ndihmojë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal” (Evidenca I.1, neni 7, neni 2)</p> <p>Ky program studimi është në përputhje të plotë me vlerat akademike dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë (neni 57, pikat 6,7) dhe me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” (Evidenca I.1).</p> <p>AU zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me objektivat e procesit të Bolonjës, respekton Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe standardet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (Evidenca I.1, neni 3).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” ofruar nga</p>



<p>ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>DEA është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e AU e shprehur në Statutin e tij, neni 2. Sipas këtij neni, ndër të tjera shkruhet se, misioni i AU-së është “të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies; të ofrojë shërbime në përputhje me misionin e tij; të zhvillojë punë shkencore në të gjitha fushat që ajo mbulon dhe të përgatisë specialistë dhe shkencëtar të rinj.” (Evidenca I.1).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Nga verifikimi i bërë Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2023-2028 të AU-së, rezulton se programi i studimit të nivelit të dytë Master Profesional në “Pedagogji” me profil . “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” është në përshtatje dhe në zbatim të saj, si dhe Statutit të këtij institucioni (Evidenca I.2 a, b; Evidenca I.1).</p> <p>Po ashtu, ky program studimi që ofrohet nga DEA, është përshtatur edhe me Planin Strategjik të këtij Departamenti (Evidenca I.4) dhe me Rregulloren e FSHSH-së (Evidenca I.5).</p> <p>Sipas Planin Strategjik të Zhvillimit të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes (2022-2023), ky program studimi që po vlerësojmë, vendosi rishikimin e kurrikulave të tij dhe ndryshoi edhe emërtimin e këtij programi studimi. “Rishikimi i kurrikulës u realizua në kuadër të rekomandimeve të bëra nga Bordi i Akreditimit por edhe duke bërë përputhjen e tij me legjislacionin në fuqi dhe plotësimin të kërkesave të tregut të punës.” (Evidenca I.4, fq. 3). “Përpara vitit akademik 2022-2023”, ky program studimi është emëruar Master profesional në “Pedagogji” me profile “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi”. Ndërsa me miratim nga MAS, me Urdhër Nr. 627, datë 20.10.2022 është emëruar Master profesional në “Pedagogji” me profile “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” (Evidenca I.4, fq. 3-4).</p> <p>Sipas Rregullores së FSHSH “Në fund të këtij trajnimi, studentit i jepet diploma “Master Profesional” në fushën e arsimimit dhe trajnimit të kryer” (Evidenca I.5, neni 25). Ndërsa sipas Urdhrit të MAS Nr. 627, datë 20.10.2022 “Në fund të këtij programi studimi lëshohet diplomë e ciklit të dytë “Master profesional në “Pedagogji” me profile “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me</p>	<p>Konstatohet se programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”, është hartuar në përputhje me strategjinë</p>

<p>strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>kombëtare, me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr.80/2015, dhe në përgjigje të nevojave të tregut të punës (<i>Evidenca I.1</i>).</p> <p>Ky program studimi, përditësohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, strategjinë e vetë institucionit dhe strukturave përbërëse të tij dhe synon të promovojë vlerat njerëzore, vlerat kulturore dhe interesat kombëtarë. Ai "... ofrohet në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtar dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare" (<i>Evidenca II.1, neni 4</i>). Misioni që AU kërkon të përmbushë përmes programeve të tij të studimit, është "të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore" (<i>Evidenca I.1, neni 2</i>).</p> <p>Riorganizimi i këtij program studimi, i bërë me Urdhër të MAS, g, dëshmon për zhvillimin dhe përshtatjen e këtij programi sipas kërkesave të kohës (<i>Evidenca H.1</i>).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se programi i studimit Master Profesional në "Pedagogji" me profil "Mësuesi në Arsim Fillor" dhe "Menaxhim Arsimi" ka synim zhvillimin e balancuar dhe të qendrueshëm të formimit me karakter akademik dhe shkencor të studentëve në fushën e arsimit. Programi i studimit i përmbush të gjitha kërkesat kombëtare dhe është konform zhvillimit strategjik dhe dokumenteve rregullatore të institucionit Albanian University.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën,</p>	<p>Sipas Statutit të Albanian University (Neni 1), "Albanian University" është vazhdues i Universitetit UFO (UFO</p>



<p>kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>University), i themeluar me Vendimin Nr. 197 datë 10.04.2004 të KM dhe riorganizuar me Vendimin Nr. 603 datë 24.03.2011 të KM” (<i>Evidenca I.1, neni 1</i>).</p> <p>Referuar Urdhrit të MASH Nr. 89, datë 10.02.2010, u bë licensimi i këtij program studimi dhe institucioni ka një përvojë prej 13 vitesh që ofron për studentët këtë program.</p> <p>Nga vlerësimi i dokumentacionit të Albanian University, FSHSH-së dhe DEA-s për programin Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”, u konstatua se:</p> <p>FSHSH për vitin akademik 2022-2023 ka 88 pedagogë gjithsej, nga të cilët 32 janë personel akademik efektiv (PAE) nga ku: 2 kanë titullin “Prof. Dr”, 6 kanë titullin “Prof. i Asociuar”, 18 kanë gradën Dr., dhe 2 Dr në proces dhe 4 Asistent Lektorë me Msc, dhe 56 janë personel akademik me kontratë (PAK) (<i>Evidenca Aneks RVB, Tabela 1</i>).</p> <p>Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes që ofron këtë program studimi, përbëhet nga një staf prej 31 pedagogësh gjithsej, prej të cilëve 9 janë personel akademik efektiv (PAE) nga ku: 1 ka gradën Prof. Dr., 2 Prof. i Asociuar dhe 6 kanë gradën Dr., dhe 22 janë personel akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Për vitin akademik 2022-2023, raporti i pedagogëve PAE/PAK të angazhuar në programin e studimit që po vlerësojmë është 5 me 5. Personeli akademik efektiv (PAE) ka këto kualifikime: një me gradën Prof. i Asociuar dhe katër me gradën Dr. Ndërsa si personel akademik me kontratë (PAK) janë: një me gradën Prof. Dr., dy me gradën Prof. i Asociuar dhe dy me gradën Dr. (<i>Evidenca Aneks RVB, Tabela 6.1</i>).</p> <p>Referuar analizës së mësipërme, universiteti, për të përmbushur objektivat e këtij program studimi, ka angazhuar burime njerëzore në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit. Evidentohet se stafi ka kualifikimet e duhura me tituj dhe grada për zhvillimin me cilësi të këtij program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe referimi prej takimeve gjatë vizitës në Institucion, konfirmuan se fusha e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” dhe planeve të nivelit bachelor që mbulon njësia kryesore FSHSH,</p>




<p>kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>është në një linjë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë DEA.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga tre njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes - Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme - Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative <p>Ky program studimi është hartuar në përputhje me fushën e veprimtarisë të këtij institucioni që është fusha e mësuesisë dhe i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Emërtimi i programit është në koherencë me atë të njësisë bazë dhe kryesore.</p> <p>Referuar RVB-së së programit dhe Shkresës së Universitetit “Albanian University” drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të datës 02.03.2023, institucioni ka përfunduar përgatitjen e kodifikimit të programeve të studimit dhe është në proces për t’u aprovuar nga MAS (<i>Evidenca I.6</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave rezulton se programet e studimit që ofron Albanian University kanë përputhje midis fushës së përgjithshme dhe specifike me fushën akademike e kërkimore të departamentit përgjegjës për programin e studimit. Kjo shprehet qartë në Rregulloren “Mbi organizimin dhe funksionimin e DEAs në Albanian University, sipas së cilës “Departamenti përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplina mësimore respektive” (<i>Evidenca II.3, neni 4</i>). Kjo përputhshmëri evidentohet në të tre programet Ciklit të I-rë të ofruara nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” (180 kredite) 2. Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” (180 kredite) 3. Bachelor në “Anglisht” (180 kredite). <p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” është program i ciklit të dytë që ky departament ofron (60 kredite) (<i>Evidenca II.3, neni 6</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” nuk</p>



drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	strukturohet jashtë profilit dhe strategjisë së zhvillimit të institucionit.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Referuar <i>Evidencës I.7</i> , Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në vitin akademik 2019-2020, ka bërë përpjekje për t'i ofruar studentëve të tij të diplomuar trajnime profesionale të mëtejshme, por pavarësisht përpjekjeve të bëra, modulet e trajnimit të përpiluara nga pedagogë të këtij departamenti pranë Shkollës së Drejtorëve CSL, nuk u pranuan. Mendojmë se këto përpjekje nuk duhet të stopohen dhe DEA duhet të këmbëngulë derisa të fillojë të zhvillojë trajnimet për mësuesit. Prandaj, duke qenë Departament i Edukimit, <i>rekomandojmë që ky departament, të ofrojë trajnime për mësuesit dhe për studentët që përfundojnë Masterin Profesional në Pedagogji me profile.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, duke u mbështetur në dokumentet e paraqitura dhe të verifikuara gjatë vizitës është i mendimit se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përvojën dhe kapacitetet e duhura për të ofruar shërbim arsimor cilësor. Programi përputhet me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe organizohet sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit dhe sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Rekomandojmë që ky departament, të ofrojë trajnime për mësuesit dhe për studentët që përfundojnë degën e mësuesisë. Bazuar në vlerësimet e mësipërme, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit



të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga GVB, konstatojmë se institucioni ka hartuar dhe miratuar një sërë udhëzimesh dhe rregulloresh të cilat sigurojnë një bashkëpunim dhe ndarje detyrash mes njësive dhe administratës për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Në statutin e institucionit në disa nene të tij si dhe në rregulloret e tërë njësive të institucionit janë përcaktuar përgjegjësitë përkatëse të punës, dhe bëhet një analizë e vazhdueshme e rezultateve të arritura (<i>Evidencat I.1, I.3, I.5, II.2, II.3, II.5</i>).</p> <p>Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes ka bashkëpunime të ngushta me dy departamentet e tjera të fakultetit: Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, dhe Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative. Ky bashkëpunim bëhet në kuadër të shkëmbimit të pedagogëve, të mësimdhënies dhe njësia kryesore FSHSH koordinon aktivitetet e këtyre departamenteve.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se kishte një bashkëpunim efektiv ndërmjet Njësive administrative si: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Karrierës dhe Alumnit, Zyra e Koordinimit dhe e Mbështetjes për Studentët, dhe njohje e plotë e detyrave dhe detyrimeve që ato kishin.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Albanian University, për të realizuar objektivat e procesit mësimor e formues të studentëve si dhe të aktiviteteve me karakter kërkimor-shkencor, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda vendit, institucione të arsimit parauniversitar dhe institucione administrative brenda vendit (<i>Evidenca I.8</i>).</p> <p>DEA ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me DRAP dhe ZVA për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të programeve “Bachelor” dhe “Master” (<i>Evidenca I.9</i>).</p> <p>Bashkëpunimet me institucione të tjera të arsimit të lartë, si me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Universitetin e Tiranës, Universitetin e Korçës “Fan Noli” janë bërë në funksion</p>

	<p>të programit të studimit dhe për organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta (<i>Evidenca I.10</i>).</p> <p>Përveç bashkëpunimit që DEA ka me KPH University, Wienn (<i>Evidenca I.12</i>) në kuadër të programit ERASMUS + për mobilitetin e studentëve (<i>Evidenca</i>) dhe të stafit akademik (<i>Evidenca I.13; I.14</i>) nuk rezultoi të kishte bashkëpunime me institucione të tjera jashtë vendit.</p> <p>Prandaj, rekomandojmë që të zgjerohen bashkëpunimet ndërkombëtare me Universitete partnere të huaja për rritjen e mundësisë për shkëmbime, bashkëpunime dhe aktivitete të përbashkëta të Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe Dea-s që ofrojnë këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit dhe gjatë vizitës në institucion, rezulton se Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka një sërë marrëveshesh në ndihmë të përmirësimit të procesit mësimor. AU dhe DEA kanë realizuar disa marrëveshje me partnerë dhe institucione të veçanta private dhe shtetërore për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të saj (<i>Evidenca I.11</i>).</p> <p>Çdo vit, DEA nënshkruan marrëveshje me DRAP dhe ZVA të qyteteve të ndryshme për ndjekjen e praktikave mësimore profesionale (<i>Evidenca I.9</i>).</p> <p>Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që DEA ka me KPH University, Wienn (<i>Evidenca I.12</i>) ka zbatuar programin ERASMUS + për mobilitetin e studentëve (<i>Evidenca I.13</i>) dhe të stafit akademik (<i>Evidenca I.14</i>) të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se informacioni i hartuar për përfitimet nga marrëveshjet dhe bashkëpunimet, siç janë ato të projekteve dhe shkëmbimit të studentëve, janë në vazhdimësi për programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.</p> <p>Në Raportin vjetor dhe në Raportin semestral të DEA-s për vitin akademik 2021-2022, një ndër zërat e përfshirë në raport, është Bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit dhe Mobiliteti i stafit dhe studentëve (<i>Evidenca I.15; III.10</i>). Në këto raporte analizohet gjithë veprimtaria mësimore dhe puna shkencore e departamentit për një vit akademik apo semestër, deklarohen mobilitetet e stafit</p>

	akademik dhe studentëve dhe analizohen përfitimet nga marrëveshjet dhe bashkëpunimet në funksion të realizimit të programeve të studimit.			
Konkluzione	<p><i>GVJ, nisur nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, deklaroi se, Albanian University, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, kanë nënshkruar një sërë marrëveshjesh me universitete dhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit që ndihmojnë në rritjen e cilësisë në realizimin e programit të studimit. Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit ishin të frytshme dhe ndihmonin në mbikëqjen, mbarëvajtjen e programit si dhe për një aftësim profesional të studentëve të Masterit Profesional me dy profile.</i></p> <p><i>Rekomandojmë që të zgjerohen bashkëpunimet ndërkombëtare me Universitete partnere të huaja për rritjen e mundësisë për shkëmbime, bashkëpunime, aktivitete dhe projekte të përbashkëta të Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe Dea-s që ofrojnë këtë program studimi.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga analiza e bërë planit mësimor të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimit” konfirmojmë se plani mësimor është hartuar duke u bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjin Nr. 80/2015 për AL, ku në nenin 75, pika 6 shkruhet “Programet e studimeve “Master profesional” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Studimet e ciklit të dytë “Master profesional” përmbyllet me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimit të kryer.” - VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar; dhe - Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). <p>Ky program studimi organizohet në lëndë, praktikë mësimore dhe provim final/punim diplome. Ai përmban një total prej 60 kreditesh, ku 1 ECTS përmban 25 orë mësimore, organizohet në dy semestra dhe ka një kohëzgjatje studimi 1 vjeçare.</p> <p>Për të dy profilet e këtij Masteri, respektohet rigorozisht ndarja e veprimtarive formuese (A-F) sipas ECTS të përcaktuara sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018 (<i>Evidenca II.1, Aneks Tabela përmbledhëse, Tab. 9.1, Tab. 9.2</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose</p>	<p>Bazuar në analizën e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimit” që ofrohet nga DEA, FSHSH të Albanian University, rezulton se struktura e ndërtimit dhe përmbajtja e tij, qëllimi dhe objektivat, synojnë të realizojnë formimin profesional të mësuesve të arsimit fillor si dhe të menaxherëve të institucioneve arsimore me dije, aftësi dhe kompetenca për t’i zbatuar në praktikën e përditshme të mësimdhënies dhe të drejtimit të IA-ve. Po ashtu, ky program studimi mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara përmes praktikave mësimore dhe synon përgatitjen dhe kualifikimin e mëtijshëm të studentëve të tij (<i>Evidenca II.1</i>).</p>

<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Këto objektiva si dhe objektivat specifike për të dy profilet, janë të përcaktuara qartë në rregulloren e këtij program studimi (<i>Evidenca II.2, neni 4</i>) dhe në dokumentet e tjera rregullatore të Albanian University (<i>Evidenca I.1; I.4: I.5</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga verifikimi i planit mësimor të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profile rezulton se ky program është hartuar konform udhëzimeve të MAS dhe udhëzimeve të vetë institucionit për praktikën profesionale dhe detyrimet mbyllëse. Në planin mësimor 2022-2023 është planifikuar dhe zhvillohet një praktikë me 6 ECTS dhe detyrimet përmbyllëse me temë Provim Diplomimi/Temë diplome me 7 ECTS (<i>Evidenca II.1, Aneks Tabela përmbledhëse, Tab. 9.1, Tab. 9.2</i>).</p> <p>Rezulton se praktika mësimore zhvillohet në shkolla sipas marrëveshjeve me ZVA-të përkatëse në qytete të ndryshme të vendit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ofron studime të ciklit të parë dhe ciklit të dytë. Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor”, është plotësim i ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor”, i cili ofrohet nga ky departament. Ndërsa programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Menaxhim arsimit” ofrohet për të gjithë studentët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor”, program i ofruar po nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes (<i>Evidenca II.2</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor 2022-2023 rezulton se Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimit” (<i>Evidenca II.1</i>) është i organizuar sipas ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 (<i>Neni 83</i>) dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (<i>Shtojca 1</i>).</p> <p>Rezultatet për kategorizimin e secilës veprimtari formuese sipas VKM 41/2018 dhe sipas planit mësimor 2022-2023 të dy profileve të Master Profesional në “Pedagogji” (<i>Evidenca II.1</i>,</p>

“Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.

Aneks Tabela përmbledhëse, Tab. 9.1, Tab. 9.2). po i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

<i>Kategorië</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Sipas VKM 41/2018</i>	<i>Sipas planit mësimor MP “Mësuesi në arsim fillor”</i>	<i>Sipas planit mësimor MP “Menaxhim arsimit”</i>
A	Lëndë bazë	5%-10%	10%	10%
B	Lëndë karakterizuese	30%-40%	40%	38%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	20%-30%	28%	30%
D	Lëndë plotësuese	10%	10%	10%
E	Detyrime përmbyllëse	10%-20%	12%	12%

Krahasimi i krediteve të shprehura në përqindje (%) për çdo kategori të standardit sipas VKM 41/2018 dhe sipas planit mësimor të këtij program studimi, tregon se këto përqindje përputhen plotësisht dhe janë konform legjislacionit në fuqi.

Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Albanian University nuk është institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.


<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë,</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes i Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Albanian University.</p>			
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Albanian University ka kryer kodifikimin kombëtar të programeve të tij të studimit konform Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe këkimin shkencor në institucionet e arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (neni 86), por ky proces akoma nuk është aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. (Evidenca I.6).</p>			
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” , nuk ofrohet si program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Lidhur me këtë standart, GVJ mendon se, programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” është tërësisht në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, (neni 75; 83; 86), me VKM 41/2018, me Statutin e Albanian University, si dhe me Rregulloren e studimeve të këtij programi.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																								
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Bazuar në verifikimin e dokumentacionit, konfirmojmë se njësia kryesore për programin e Master Profesional në “Pedagogji” me profile, është Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe ky fakultet funksionon konform legjislacionit në fuqi. Referuar Rregullores së FSHSH-së, “Struktura organizative e Fakultetit të Shkencave Shoqërore përbëhet nga autoritetet drejtuese, organe drejtuese, njësitë bazë të punës mësimore-shkencore dhe nga administrate.</p> <p>Autoritete drejtuese akademike janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Dekani Zëvendës dekani Përgjegjësit e Departamenteve <p>Njësitë bazë mësimore-shkencore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative Departamenti i Psikologjise së Përgjithshme Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes (<i>Evidenca I.5, neni 1; 7</i>), <p>duke përmbushur detyrimin e përcaktuar në Ligjin 80/2015, (<i>neni 23/1,2,3</i>).</p> <p>Referuar dokumenteve të dorëzuara, konstatojmë se FSHSH për vitin akademik 2022-2023 ka 88 pedagogë gjithsej, nga të cilët 32 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 56 janë personel akademik me kontratë (PAK) (<i>Tabela Aneks RVB, Tab. 1</i>).</p> <table border="1" data-bbox="639 1368 1406 1850"> <thead> <tr> <th><i>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</i></th> <th><i>PAE</i></th> <th><i>PAK</i></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>6</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>18</td> <td>26</td> </tr> <tr> <td>Dr. Proces</td> <td>2</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>MSc</td> <td>4</td> <td>17</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>32</td> <td>56</td> </tr> <tr> <td></td> <td colspan="2" style="text-align: center;">88</td> </tr> </tbody> </table>	<i>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</i>	<i>PAE</i>	<i>PAK</i>	Prof. Dr.	2	2	Prof. As. Dr.	6	11	Dr./PhD.	18	26	Dr. Proces	2	0	MSc	4	17	Gjithsej	32	56		88	
<i>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</i>	<i>PAE</i>	<i>PAK</i>																							
Prof. Dr.	2	2																							
Prof. As. Dr.	6	11																							
Dr./PhD.	18	26																							
Dr. Proces	2	0																							
MSc	4	17																							
Gjithsej	32	56																							
	88																								



	<p>Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes, si njësi bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi, funksionon në bazë të Rregullores së departamentit (<i>Evidenca II.3</i>) dhe duke qenë pjesë e FSHSH-së, plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në Ligjin 80/2015, (neni 23/3).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” është akredituar së fundmi nga Bordi i Akreditimit të ASCAL me Vendim Nr. 22, datë 03.03.2023 (https://www.ascal.al/sq/bordiakreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-03-mars-2023).</p>																								
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes është struktura bazë përgjegjëse për këtë program studimi dhe plotëson të gjitha kërkesat ligjore dhe nënligjore për organizimin akademik dhe strukturor të tij (<i>Ligji Nr. 80/2015, neni 25</i>).</p> <p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar (<i>Tabela I.1</i>), GVJ konstaton se DEA ka në përbërje të tij 9 personel akademik efektiv dhe 9 personel akademik me kontratë, titujt dhe gradat e të cilëve po i paraqesim sipas tabelës së mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="644 1059 1407 1579"> <thead> <tr> <th><i>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes</i></th> <th><i>PAE</i></th> <th><i>PAK</i></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>6</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Dr. Proces</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>MSc</td> <td>0</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>9</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td></td> <td colspan="2" style="text-align: center;">18</td> </tr> </tbody> </table> <p>Po ashtu, në këtë departament angazhohen 7 punonjës si personel administrativ duke përmbushur plotësisht kriterin e përcaktuar nga Ligji Nr. 80/2015 neni 25/4, sipas të cilit “<i>Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada</i></p>	<i>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes</i>	<i>PAE</i>	<i>PAK</i>	Prof. Dr.	1	1	Prof. As. Dr.	2	1	Dr./PhD.	6	5	Dr. Proces	0	0	MSc	0	2	Gjithsej	9	9		18	
<i>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes</i>	<i>PAE</i>	<i>PAK</i>																							
Prof. Dr.	1	1																							
Prof. As. Dr.	2	1																							
Dr./PhD.	6	5																							
Dr. Proces	0	0																							
MSc	0	2																							
Gjithsej	9	9																							
	18																								

	<p><i>shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik.”</i></p> <p>Për këtë program studimi, angazhohen 5 pedagogë PAE dhe 5 pedagogë PAK. Nga analiza që i bëme Planit mësimor të lidhur me personelin akademik (Tabela 12), për përqindjen e orëve mësimore që mbulon personeli efektiv ndaj atij me kontratë, rezultoi se personeli akademik efektiv mbulon 70% të ngarkesës mësimore të këtij program studimi (669 orë nga 953 orë gjithsej).</p> <p>Bazuar në udhëzimin Nr.29 datë 10/09/2018 e MASR, Senati Akademik i Albanian University ka marrë vendim që ngarkesa mësimore vjetore për autoritetet drejtuese dhe personelin akademik të jetë në përputhje me nevojat e njësive bazë.</p> <p>Për zhvillimin e praktikës mësimore të këtij program studimi angazhohet një pjesëtar i personelit akademik efektiv (Tabela 12).</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Konfirmojmë se Departamenti i Edukimi dhe Anglishtes, ka vendosur nga një koordinatör për secilin program studimi që ofron, përfshirë edhe programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimit” (Evidenca II.5; II.3, neni 11).</p> <p>Referuar RVB-së dhe bisedave në institucion, deklarojmë se për ndjekjen e praktikave mësimore të këtij program studimi janë angazhuar dy pedagogë të këtij departamenti diktuar nga numri relativisht i lartë i studentëve.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mendon se njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, ka një personel akademik të mirë kualifikuar me grada e tituj shkencorë dhe personel të mjaftueshëm administrativ për realizimin e programit të studimit. Ky program studimi drejtohet nga një koordinatör dhe DEA ka organizuar praktikat mësimore në përputhje me rregulloret e institucionit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Rezulton se, nga verifikimi i dokumentacionit që disponon njësia kryesore bazë e programit të studimit, DEA ka tërë informacionin e nevojshëm si për organizimin e programit ashtu edhe për strukturën dhe përmbajtjen e tij. Ky departament disponon të gjitha vendimet e marra nga Senati për organizimin e këtij programi, rregulloren e studimit të këtij programi ku përcaktohen në detaje struktura dhe përmbajtja, rregullorja e pranimit me kriteret dhe procedurat e realizimit të konkursit, etj.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Konfirmojmë se pjesë e këtij programi të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimit” është edhe plani mësimor i detajuar sipas udhëzimeve të MAS dhe të rregulloreve të miratuara për këtë program studimi. Në planin mësimor ndarja e lëndëve është bërë sipas të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Per elementët e programeve të studimit te ofruara nga IAL e ndryshuar” dhe të vlerësuara me kredite sipas sistemit kombëtar dhe evropian akademik. Në planin mësimor janë të pasqyruara ngarkesa e lëndëve, raporti brenda dhe jashtë auditorit, pikët kreditet, etj. (Tabelat Aneks RVB).
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Konfirmojmë se Albania University ka hartuar një Rregullore të veçantë (2020) përsa i përket kriterëve të “Regjistrimeve dhe transferimeve të studimeve” sipas së cilës studentëve u sigurohet i gjithë informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (Evidenca II.6).

<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes, si përgjegjës i realizimit të këtij programi studimi, ka organizuar programet lëndore sipas formatave të miratuara. Syllabuset përmbajnë komponentët e nevojshëm dhe informacionin mbi organizimin e secilës lëndë dhe praktikë profesionale. Ato përmbajnë informacion të hollësishëm mbi ngarkesëm mësimore në auditor dhe jashtë tij, kriteret e frekuentimit të lëndës, vlerësimit të studentëve dhe detyrimet e studentit për t'u sjellë sipas Kodit të Etikës të institucionit (<i>Evidenca II.7</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Programet e lëndëve dhe materialet e tjera rishikohen çdo vit akademik duke pasqyruar ndryshimet e bëra në masën e lejuar dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore me qëllim përmirësimin e tyre.</p> <p>DEA bën rishikimin dhe përditësimin e programeve të studimit, planit mësimor dhe syllabuseve, bazuar në nevojat dhe treguesit akademik.</p> <p>Ky proces kryhet nga titullarët e lëndëve, në bashkëpunim me koordinatoret e e grup lëndëve të mbikëqyrur nga grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti. Pas miratimit të ndryshimeve nga Përgjegjësi i Departamentit, syllabuset e ndryshuara së bashku me rregulloret përkatëse dërgohen pranë Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave përpara fillimit të vitit akademik (<i>Evidenca II.8</i>).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Jemi të mendimit se programi i studimit Master Profesional në "Pedagogji" me profil "Mësuesi në Arsim Fillor" dhe "Menaxhim Arsimi" është i organizuar dhe i strukturuar në përputhje me objektivat formuese të një programi të nivelit të dytë, duke përmbushur të gjitha kriteret që kërkohen.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur, rezulton se në këtë program studimi, gërshëtimi i lëndëve sipas veprimtarive formuese në lëndë: karakterizuese, integruese dhe plotësuese, ndihmon studentët në aftësimin e zhvillimin e tyre profesional dhe rrisin mundësinë për punësimin e tyre të ardhshëm ashtu siç parashikohet edhe në planin strategjik të departamentit (<i>Evidenca I.4</i>).</p> <p>Ky program studimi është një vijim i thelluar i njohurive të marra në nivelin e parë të studimit Bachelor por duke patur si risi ofrimin për studentë të mundësinë të marrin informacion në fushën didaktike e praktike të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profile është strukturuar në veprimtari formuese A, B, C, D, E, që realizohen në një shtrirje kohore 1 vjecare me 2 semestra dhe me 60 kredite (ECTS) gjithsej. Programi ka një kurrikulë të balancuar të lëndëve dhe krediteve dhe një përzgjedhje e kujdesshme vlerësimi në kredite e orë mësimore të lëndëve. Lëndët mundësojnë arritjen e objektivave nga njohuritë e marra në nivelin paraardhës Bachelor dhe thellimin e tyre në këtë nivel masteri profesional.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi,</p>	<p>Rezulton se struktura e këtij program studimi, plani mësimor, ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe bazuar edhe në eksperiencën ndërkombëtare me programe të ngjashme.</p> <p>Plani mësimor i këtij programi i ka dhënë shumë përparësi praktikave mësimore dhe orëve të ushtrimeve/laboratorëve duke synuar një formim të plotë teorik dhe praktik të studentëve. Orët e praktikave profesionale zënë 120 orë nga 542 gjithsej për MP në Pedagogji me profil “Mësuesi në Arsimin Fillor dhe 120 orë nga 581 gjithsej për MP në Pedagogji me profil “Menaxhim Arsimi” (<i>Tabelat 13.1; 13.2</i>),</p>

kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Studentët thellojnë njohuritë e tyre lidhur me lëndë të tilla, si: Pedagogjinë e përgjithshme, Vlerësimin dhe standardet në edukim, Hartimin dhe zhvillimin e kurrikulës, Legjislacionin dhe reformën arsimore, Të mësuarit me projekte, etj. Në fund të këtij program studimi, studenti fiton aftësitë, kompetencat për një formim të thelluar në fushën e mësuesisë (<i>Tabela 12;13</i>).
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Duke analizuar planin mësimor të këtij program studimi (<i>Tabela 10; 11</i>) në aspektin e raporteve mes lëndëve të shtrira sipas veprimtarive formuese dhe raportin teori praktikë brenda vetë lëndëve të një tipi veprimtarie, rezulton se ky plan mësimor i krijon mundësi studentëve jo vetëm që të kenë mundësinë për njohjen dhe transferimin e studimeve apo realizimin e mobiliteteve në universitete homologe jashtë vendit, por edhe hapësira më të mëdha punësimi.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar, titullave të lëndëve u kërkohet që të bëjnë përditësimin e tyre në fillim të çdo viti akademik (<i>Evidenca II. 8</i>). Nga verifikimi i syllabuseve, deklarohet se një pjesë e tyre ishte e përditësuar me literaturë të 5-10 viteve të fundit, ndërsa pjesa tjetër përmbante literaturë kryesisht të 20-15 viteve të mëparshme. P.sh., sjellim në vëmendje se pavarësisht syllabusi i lëndës “Teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies”, i përkiste vitit akademik 2022-2023, akoma punohej me Strategjinë Kombëtare të 2014-2020, ndërkohë që po zbatohet Strategjia Kombëtare 2021-2026. <i>Rekomandojmë përditësim të një pjese të syllabuseve me literaturë të 5 viteve të fundit.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Nga analiza e përmbajtjes së programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profile, mund të konfirmojmë se, ky program mundëson formimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në përputhje me objektivat dhe synimet e përcaktuara. Ky program studimi është në përputhje edhe me Ligjin 10247, datë 26.05.2010 Për kornizën shqiptare të kualifikimeve (<i>neni 6</i>). <i>Sugjerojmë që për të dy profilet e programit, lënda “Metodat e kërkimit shkencor” nga lëndë me zgjedhje të vendoset lëndë e detyruar, sepse për një student që përfundon studimet e masterit</i>

	<i>profesional është e domosdoshme formimi i tij me metodikat e kërkimit shkencor.</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Rezulton se përmbajtja e Programit të Studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” i jep mundësinë studentëve të diplomuar për t’u punësuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Institucionet e arsimit të lartë parauniversitar; - Zyrtarë arsimore vendore; - Njësitë e qeverisjet vendore; - Menaxher të OJF-ve me fokus arsimin (<i>Evidenca II.9</i>). <p>Por meqenëse ky program studimi është Master profesional, studentët e diplomuar në këtë program nuk kanë të drejtë të aplikojë për studime të ciklit të tretë (doktoraturë), kjo bazuar në nenin 78/1 të Ligjit 80/2018, ku shkruhet “Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Masteri shkencave” ose “Master i arteve” dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë”.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ arrin në konkluzionin se struktura dhe përmbajtja e programit të studimeve Master Profesional në “Pedagogji” me profil . “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe . “Menaxhim Arsimi” është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe objektivave të programit, duke garantuar formimin e kompetencave mësimdhënëse dhe drejtuese në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>Rekomandojmë përditësim të një pjese të syllabuseve me literaturë të 5 viteve të fundit dhe sugjerojmë që për të dy profilet e programit. Sugjerojmë që lënda “Metodat e kërkimi shkencor” nga lëndë me zgjedhje të vendoset lëndë e detyruar, sepse për një student që përfundon studimet e masterit profesional është i domosdoshëm formimi i tij me metodikat e kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Konfirmojmë se programit i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”, është riorganizuar me UMAS nr. 509, datë 06.09.2022 (<i>Evidenca H 1</i>). Në kuadër të riorganizimit, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka zhvilluar edhe një studim të tregut të punës (<i>Evidenca II.9</i>). Riorganizimi ka synuar jo vetëm ndryshimin në emërtim të programit, por edhe rritjen e cilësisë së tij.</p> <p>Nga bisedat e zhvilluara në institucion na u siguria se Departamenti nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit mbante kontakte me partnerë strategjikë akademikë, panairë të punës dhe biznesit për t’u konsultuar dhe për të përmirësuar programet e studimit sipas nevojave të tregut të punës. Po ashtu, bashkëpunimi i DEA-s me aktorë të tjerë si institucione homologe vendase dhe të huaja, të diplomuar, përfaqësues të institucioneve arsimore, etj., është tregues që ky departament punon për rritjen e cilësisë së programeve të tij të studimit (<i>Evidencat I.4; I.8; I.12; I.13; I.14</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës na u konfirmua se FSHSH, dhe DEA që ofrojnë programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profile, realizon një feedback me studentët dhe strukturat e tyre përmes sugjerimeve të bëra në Njësinë Bazë dhe përmes pyetësorëve të zhvilluar nga NjsBC çdo semestër/vit akademik (<i>Evidenca III.7</i>).</p> <p>Ndërsa Zyra e Karrierës dhe Alumni marrin feedback dhe konsultoheshin me studentë të diplomuar në këtë program studimi me qëllim marrjen e sugjerimeve të tyre për të përmirësuar më tej kurrikulat e këtij programi për t’u përshtatur më shumë me kërkesat e tregut të punës.</p>

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” , i përket fushës së mësuesisë. Si i tillë, ai i përket profesioneve të rregulluara dhe programi ofrohet dhe përditësohet në përputhje me zhvillimet e fundit të fushës së mësuesisë. Si pasojë, janë këto ndryshime që diktojnë edhe ndryshimet në këtë program studimi.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon se FSHSH dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes organizojnë një sërë bashkëpunimesh me aktorë të tjerë si institucione homologe vendase dhe të huaja, studentë të diplomuar, përfaqësues të institucioneve arsimore, partnerë strategjikë akademikë, me panairë të punës dhe biznesit, me qëllim konsultimin dhe përmirësimin e këtij program studimi sipas nevojave të tregut të punës.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.6</p>	
<p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Bazuar në analizën e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil. “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe. “Menaxhim Arsimi” , rezulton se janë përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat e Albanian University (<i>Evidenca I.1, neni 7</i>).</p>



	<p>“Ky program është hartuar në përputhje me misionin, qëllimet e institucionit dhe strategjinë për zhvillim të institucionit” (Evidenca II.2, neni 4/1).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Sipas Statutit të AU-së, “Albanian University gëzon liri akademike në mësimdhënie, në kërkimin shkencor dhe në krijim, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015” (Evidenca I.1, neni 5).</p> <p>Nga takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë si dhe me stafin akademik rezulton se ka një bashkërendim të tërë strukturave të angazhuara në realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”.</p> <p>Personeli akademik PAE dhe PAK i DEA-s është i kualifikuar me grada dhe tituj shkencor. Ndërsa strukturat e tjera mbështetëse për zhvillimin normal të këtij program studimi, janë personeli ndihmës-akademik i FSHSH-së.</p> <p>Referuar RVB-së dhe vizitës në AU, personeli administrativ përbëhej nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryesekretari i Sekretarisë mësimore; - Sekretarët e Sekretarisë Mësimore; - Administratori i FSHSH; - Punonjës biblioteke FSHSH; - Specialisti i IT
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Evidentojmë se Albanian University dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes realizojnë përfshirjen e studentëve në projekte, studime, konferenca, etj. Ky departament në bashkëpunim me departamentet e tjera, organizon çdo vit konferencën studentore në të cilën vetë studentët referojnë kumtesat e tyre (Evidenca II.10).</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitur, konstatojmë se DEA harton në fillim të vitit akademik buxhetin e tij, i cili është pjesë e buxhetit vjetor të Albanian University. Në këtë buxhet, pasqyrohen të gjitha aktivitetet dhe burimet financiare për realizimin e tyre (Evidenca II.11).</p>

të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Sipas RVB-së së këtij program studimi (fq. 16), shpenzimet e bëra nga konferencat shkencore apo studentore, ishin të mbuluara nga Albanian University.			
Konkluzione	<p><i>GVJ konfirmon se ky program studimi ka të përcaktuara qartë prioritetet, objektivat dhe qëllimet në aspektin e studimit dhe të kërkimit shkencor. Realizimi i tyre bëhet bazuar në një bashkëpunim të efektshëm të tërë njësive të Albanian University, FSHSH-së dhe DEA-s duke përfshirë dhe nxitur aktivisht studentët në këtë proces.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>DEA si pjesë e FSHSH së Albanian University dhe përgjegjëse e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimit” operon në koordinim me grupet lëndore që janë pjesë e strukturës së saj për realizimin e objektivave të programit të studimit që lidhen me kërkimin shkencor. Departamenti bashkëpunon me Zyrën e Kërkimit shkencor dhe Botimeve Akademike dhe është pjesë e Projektit “Resilience” (<i>Evidenca II.12</i>).</p> <p>Rezulton se DEA, aplikon në mënyrë të vazhdueshme në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare (<i>Evidenca II.13</i>).</p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin	<p>Departamentit, kur i kërkohet nevoja për të bërë studime, angazhon stafin e tij akademik. Kështu, në kuadër të riorganizimit të këtij program studimi (në vitin akademik 2022-2023), Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka zhvilluar një studim të tregut të punës për nevojën që ka vendi ynë për mësues të arsimit fillor dhe specialistë të arsimit. Për zhvillimin e këtij studimi, DEA kishte përfshirë 3 anëtarë të tij (<i>Evidenca II.9</i>).</p>

<p>akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, pjesë e FSHSH-së, ka një axhendë aktive në organizimin e aktiviteteve akademike dhe konferencave. Ky departament në bashkëpunim me departamentet e tjera organizon çdo vit konferenca shkencore dhe konferenca studentore (<i>Evidenca II.10</i>).</p> <p>Gjatë vitit akademik 2022-2023 u organizua një konferencë shkencore ndërkombëtare dhe një konferencë studentore. Konferenca shkencore ndërkombëtare u realizua në bashkëpunim me KPH University Wienn me temë “Quality education for all” (<i>Evidenca II.14</i>).</p> <p>Ndërsa konferenca studentore me temë “Varësitë nga substancat”, e mbajtur në qershor të 2023, shënoi konferencën e tetë studentore që organizohet nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore (<i>Evidenca I.10</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” formon profesionistë në fushën e arsimit dhe është konkurrues si për tregun kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Duke analizuar strukturën dhe përmbajtjen e objektivat e tij për formim të studentëve në aspektin mësimdhënës dhe drejtues të IA-ve, konkludojmë se Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes, përgjegjës për këtë program studimi, ka marrë në konsideratë të gjitha sugjerimet nga MAS, (<i>Ligji Nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara”</i>). Si rezultat, njësia përgjegjëse ndjek me korrektësi urdhërat dhe rekomandimet me qëllim që studentët pas diplomimit të ndjekin praktikën profesionale dhe t’i nënshtrohen provimit të licencës.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva</p>	<p>Rezulton se programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe udhëzimet e MAS për profesionet e rregulluara ku përfshihet edhe mësuesia (<i>Ligji Nr. 10171, datë 22.10.2009 Për profesionet e rregulluara</i>).</p>

dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes është pjesë edhe e një rrjeti ndërkombëtar mbi edukimin ETEN – European Teacher Education Network (<i>Evidenca II.15</i>).			
Konkluzione	GVJ konkludon se Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” bashkërendon veprimtaritë e tërë strukturave të saj për realizimin e objektivave të programit të studimit dhe veprimtarisë shkencore, me një bashkëpunim të vazhdueshëm me partnerë ndërkombëtarë dhe me një angazhim të studentëve cilësorë në këto veprimtari. DEA ka zbatuar të gjitha aktet ligjore lidhur me kërkesat për profesionin e rregulluar në fushën e mësuesisë. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet,	Konstatojmë se plan-programi përfshin aktivitete mësimore si: janë leksione, seminare, detyra kursi dhe praktikë. Syllabuset e çdo lënde kanë në përmbajtjen e tyre forma të ndryshme si leksioni, diskutimi, punë në grupe, detyra, etj. (<i>Tabela 13</i>).

<p>seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Përmes punës së pavarur individuale dhe në grup, inkurajohen studentët të kryejnë detyrat që caktohen nga pedagogët e lëndëve. Në plan-programe përfshihet gjithashtu edhe mënyra e vlerësimit, e cila përbëhet nga disa komponentë të përcaktuara qartë në çdo syllabus. Nota përfundimtare e studentit llogaritet duke marrë në konsideratë përgatitjen e vazhdueshme, frekuentimin, provimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit dhe provimin përfundimtar (<i>Evidenca II.7</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga analiza e syllabuseve të programit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimit”, konstatohet se personeli akademik përdor forma dhe metoda mësimdhënëse në përputhje me natyrën e programit dhe të mundësive të studentëve. Nga vizita në institucion na u siguroi se pedagogët janë të hapur në lidhje me vlerësimet e tyre duke argumentuar çdo kriter mbi të cilën bëhet ky vlerësim. Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi rezultatet e tyre në çdo lëndë. Në ndihmë të studentit është edhe Sekretaria mësimore e cila i informon studentët mbi vlerësimet semestrale dhe vjetore.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Albanian University dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore rezulton se mbështet pedagogët për kualifikimin e tyre në aspektin didaktik duke krijuar mundësi për mbështetje financiare për zhvillim profesional dhe për pjesëmarrjen e tyre në projektet e ERASMUS+.</p> <p>AU ofron mbështetje pedagogjike profesionale për stafin e tij akademik përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare - Mundësi financimi për botime në revista ndërkombëtare me faktor impakti dhe të rankuara në Scopus (<i>Evidenca III.1</i>) - Trajnime mbi metodat risi në mësimdhënie (<i>Evidenca III.2</i>) - Mundësi për të botuar artikuj e punime shkencore në revistën e institucionit “OPTIME” (<i>Evidenca III.3</i>)
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe dokumentacionit të dorëzuar, konfirmohet që personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar me tituj e grada shkencore</p>

<p>shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>që i korrespondon programit të studimit dhe me një eksperiencë shumëvjeçare në mësimdhënie.</p> <p>Për vitin akademik 2022-2023, të angazhuar në këtë program studimi janë 5 personel akademik efektiv (PAE) dhe 5 personel akademik me kontratë (PAK) (<i>Tabela Aneks RVB, Tab. 6.1</i>).</p> <p>Biseda në institucion me anëtarë të departamentit theksoi se, bazuar në specifikën e programit të studimit, pedagogët përdornin metodologji të më të fundit në mësimdhënie, si: studime rastesh konkrete, orë mësimore stimuluese, detyra kursi, etj., dhe forma të ndryshme vlerësimi, si: diskutime individuale dhe në grup, detyra kursi, vlerësim dosjesh dhe vlerësimet me shkrim (të ndërmjetme dhe semestrale) (<i>Evidenca II.7</i>).</p> <p>Në strategjinë e vet të zhvillimit, Albanian University i konsideron studentët e saj pjesë integrale e vlerësimit të plan-programeve, përdorimit të metodave të mësimdhënies nëpërmjet terheqjes së mendimit të tyre në komisionet ad-hoc, në Departament dhe Senatit akademik, struktura në të cilat ata janë të përfshirë. Përveç këtyre, Albanian University, Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe DEA, i përfshin studentët në trajnime informuese, leksione të hapura, konferenca duke kontribuar kështu në rritjen e tyre profesionale dhe krijimin e marrëdhënieve të mira pozitive të bashkëpunimit institucion-student (<i>Evidenca V.10</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni përpiqet të inkurajojë dhe zbatojë format interaktive në mësimdhënie. Për këtë, AU përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e lëndëve, programeve të studimit dhe mësimdhënies, përfshirë këtu edhe studentët.</p> <p>Nga takimi me studentë rezulton se departamenti ka përfshirë studentët në këtë proces dhe ka marrë mendimet dhe sugjerimet e tyre për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit dhe stafit akademik (<i>Evidenca III.7</i>). Biseda me studentë konfirmoi se ata shprehnin mendimin e tyre të lirë pa hezitim në lidhje me çdo problematikë të vënë re dhe ky proces realizohej (në mënyrë anonime) përmes plotësimit të pyetësorëve të cilët u dërgoheshin studentëve përmes një linku.</p>



<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Albanian University ka ngritur disa mekanizma që ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, kurikulave dhe mësimdhënies:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i vetëvlerësimit të programit të studimit (<i>Evidenca III.4</i>). - Raport vlerësimi për stafin akademik nga drejtuesi i njësisë bazë (<i>Evidenca III.5</i>). <p>Në Raportin e vetëvlerësimit, DEA realizon vlerësimin e tij bazuar në treguesit e performancës në mësimdhënie, hulumtim dhe në raportin vjetor të departamentit dhe çdo masë strategjike të tij. Për zhvillimin profesional të stafit të tij, gjatë vitit akademik 2022-2023, DEA organizoi leksionin e hapur me lektorë të huaj për zhvillimin e metodave të reja në mësimdhënie (<i>Evidenca III.6</i>).</p> <p>Departamenti nën drejtimin e FSHSH-së zhvillon një plan veprimi për përmirësimin e programeve të studimit bazuar në rekomandimet e Bordit të Akreditimit. DEA mbikëqyr zbatimin e planit të veprimit dhe rekomandimet për të korigjuar çdo mangësi të raportuar në raport.</p> <p>Pyetësi i studentëve (<i>Evidenca III. 7.a</i>), analiza e të dhënave nga fokus grupet (<i>Evidenca III. 7.b</i>) dhe raporti i vetëvlerësimit të stafit akademik (<i>Evidenca III.8</i>), janë instrumente të tjerë që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies për këtë program studimi.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konfirmon se Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes angazhon në këtë program studimi një staf të kualifikuar me grada e tituj dhe me një eksperiencë të gjatë në mësimdhënie. Institucioni mbështet zhvillimin profesional të stafit të tij dhe përdor mekanizma të ndryshëm për vlerësimin dhe përmirësimin e programit të studimit duke bërë pjesë të këtij vlerësimi edhe studentët. Personeli akademik përdor një larmishmëri metodash të mësimdhënies me qëllim aftësimin profesional e shkencor të studentëve, duke integruar dhe nxitur studentët në këtë proces.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>


Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Albanian University ka një procedurë të përcaktuar qartë dhe transparente në Rregulloren e programit të studimit në lidhje me vlerësimin e njohurive të studentëve (<i>Evidenca II.2, neni 29</i>) dhe në Rregulloren e FSHSH-së (<i>Evidenca I.5, neni 38</i>). Këto rregullore u vihen në dispozicion të studentëve që në orët e para.</p> <p>Në orën e parë të prezantimit të lëndës, çdo lektor u bën të ditur studentëve mënyrën e kontrollit dhe të vlerësimit të njohurive.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve sipas rregullores obligon pedagogët ta bëjnë atë prezent para studentëve që në orën e parë të mësimit. Gjatë takimit me stafin akademik dhe me studentë u konfirmua se në fillim të çdo viti akademik, studentëve ju prezantohen nga anëtarët e stafit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetencat e lëndës - Përshkrimi i lëndës - Rezultatet e mësimnxënies - Metodatat e vlerësimit të lëndës - Literatura për zhvillimin e lëndës. <p>Po ashtu, studentët mund të aksesojnë syllabusin e çdo lënde gjatë gjithë vitit akademik (<i>Evidenca II.7</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Duke ju referuar dokumenteve rregullatore të institucionit: Rregullores së përgjithshme (<i>Evidenca I.3, neni 52</i>), Rregullores së programit të studimit (<i>Evidenca II.2, neni 29</i>), si dhe syllabuseve lëndore (<i>Evidenca II.7</i>), rezultojnë se stafi akademik i programit Master Profesional në “Pedagogji” me profil . “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe . “Menaxhim Arsimit”, përdor një tërësi formash testimi dhe vlerësimi gjatë vitit akademik dhe ka një sistem vjetor vlerësimi.</p>

	<p>Në <i>nenin 29 të Rregullores së programit të studimit</i> theksohet “Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi përfundimtar 60 pikë (60%) 2. Pjesëmarrja aktive në seminar 10 pikë (10%) 3. Ese/prezantim/punë në grup 10 pikë (10%) 4. Provim i ndërmjetëm 20 pikë (20%)” <p>Kontrolli i dijes bëhet me shkrim, me detyra kursi dhe me dorëzim dosje (praktika). Studenti nuk pranohet ne sesionin e parë të sezonit të provimeve nëse ka frekuentuar më shumë se 25% të orëve mësimore. Nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës, vlerësimi përfundimtar përmbledh të gjithë mënyrat e vlerësimit të lartpërmendura (<i>Evidenca II.7</i>).</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ është i mendimit se në realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimit”, stafi akademik përdor konform dokumenteve rregullatore të saj, forma të larmishme të mësimdhënies dhe kontrollit të njohurive dhe dijeve duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në	Në Albanian University studenti vlerësohet gjatë gjithë vitit akademik. Bazuar në <i>nenin 52 të Rregullores së përgjithshme të AU</i> , përcaktohet se “në vlerësimin e dijes së studentit pedagogu, si rregull, mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm si dhe në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive



<p>vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>në leksione, seminare, ushtrime, praktika, punë krijuese, punime të ndryshme dhe detyra kursi”.</p> <p>Elementët e mësipërm zënë 40% të vlerësimit përfundimtar të çdo lënde dhe vlerësimi përfundimtar reflekton rezultatin integral të të gjithë vitit sipas syllabusit të lëndës respektive (<i>Evidenca II.2, neni 29; II.7</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar RVB-së (fq. 21), Albanian University nuk përdor sisteme elektronik të testimit dhe vlerësimit të njohurive. Procedura për zhvillimin e provimeve përfshinte sekretimin e fletës së provimit, gjë që i jep mundësi studentit të ketë objektivitet në vlerësim.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Secili titullar lënde bën vlerësimin e lëndës së tij bazuar në syllabuset e miratuara në departament (<i>Evidenca II.7</i>). Zhvillimi, mbikqyrja dhe mbarëvajtja e provimeve realizohet konform Rregullores së programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil . “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe . “Menaxhim Arsimit” (<i>Evidenca II.2, neni 23, 24, 26</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në bisedën e zhvilluar me studentë të programit të studimit, konfirmojmë se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet edhe me komente e diskutime të hapura. Na u konfirmua që brenda javës së parë pas provimit të pjesshëm dhe pas provimit përfundimtar, titullarët e lëndëve pas korrigjimit të provimeve, bënë ballafaqimin e korrigjimit me studentin. Kjo praktikë mbështetet edhe në Rregulloren e programit të studimit “Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit ... ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si deh me pikët në çdo rubrikë ” (<i>Evidenca II.2, neni 28</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Albanian University ka një procedurë strikte për kryerjen e provimeve dhe mbikëqyrjen e tyre. Një sërë veprimesh të palejuara në sallën e provimit janë parashikuar dhe rregulluar përmes një sërë nenesh të Rregullores së programit të studimit (<i>Evidenca II.2, Kreu IV</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen</p>	<p>Siç e kemi shprehur edhe në Standardin III.2, kontrolli i dijeve të studentëve realizohet përgjatë gjithë viti akademik dhe në përputhje me syllabuset lëndore. Stafi akademik ka një afat prej</p>

në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	7 ditësh për vlerësimin dhe dorëzimin e rezultateve pranë sekretarisë mësimore. Njohja e rezultateve bëhet edhe përmes sekretarisë mësimore (<i>Evidenca II.2, neni 28</i>) edhe përmes sistemit online PITAGORA.			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga analiza e dokumentacionit rezulton se në Nenin 28 (pika 3, 4, 5, 6) të Rregullores së programit të studimit, janë të pasqyruara të gjitha procedurat për njohjen e studentit me vlerësimin dhe garantohet e drejta e studentit për raste kur ka kontestim të vlerësimit. Në takimin me studentë u konfirmua nga ata se nëpërmjet platformës PITAGORA dhe me e-mail mermin në kohë vlerësimin e provimit të kryer, si dhe i njihnin mirë procedurat e rishikimit të vlerësimit, anikimin, ngritjen e një komisioni të ri vlerësimi, etj. (<i>Evidenca II.2, neni 28</i>).			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rastet kur studentit është i pakënaqur me rezultatin e provimit, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. Pas ankimit të provimit nga ana e studentit, Dekani i fakultetit përkatës ngre një komision ad-hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkalidhet proces-verbalit të provimit (<i>Evidenca II.2, neni 28/3,4,5,6</i>).			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se institucioni përdor forma dhe procedura të vlefshme vlerësimi duke garantuar një vlerësim objektiv dhe në kohë nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe platformës PITAGORA. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit dhe të gjitha procedurat e tjera, të cilat mbështeteshin në dokumentet rregullatore të AU-së. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil . “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe . “Menaxhim Arsimi” është program i nivelit të dytë dhe është vazhdim i thelluar i programit të nivelit të parë Bachelor që ofrohen nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.</p> <p>Referuar Rregullores së këtij program studimi, “Ky program shmang përsëritjen e njohurive formuese të programeve të studimit të ciklit të parë, pasi ofron disiplina të karakterit profilizues profesional” (<i>Evidenca II.2, neni 4</i>). Ky program synon thellimin e njohurive të studentëve lidhur me Pedagogjinë e përgjithshme, Vlerësimin dhe standardet në edukim, Hartimin dhe zhvillimin e kurrikulës, Legjislacionin dhe reformën arsimore, Bazat e drejtimit dhe administrimit në arsim, Inspektimi dhe supervizimi në arsim, etj. (<i>Tabela 9.1 dhe 9.2</i>).</p> <p>Strukturimi i këtij programi jep mundësi studentëve që të zhvillojnë aftësitë profesionale në një qasje ndërdisiplinore por edhe krijimin e mundësive per tregun e punës edhe si specialist i arsimit edhe si mësues.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil . “Mësuesi në Arsim Fillor” rezulton se ka një lëndë (Teknologjia në mësimdhënie) e cila ka si objektiv të saj zhvillimin e aftësive teknologjike në shërbim të profesionit të mësuesit të arsimit fillor. Ndërsa në profilin . “Menaxhim Arsimi”, nuk ka një lëndë që garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit (<i>Tabela 9.1 dhe 9.2</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga FSHSH dhe DEA, në fund të çdo semestri, çdo titullar lëndë dorëzon pranë njësisë bazë, raportin e vetëvlerësimit të programit (<i>Evidenca III.8</i>).</p> <p>Ky raport siguron matjen e gjithë indikatorëve për realizimin me sukses të lëndës apo modulit, si: qëllimet e kursit dhe shkallën e përmbushjes së tyre, shkallën e realizimit të programit, arritjen e kompetencave, literaturën e përdorur duke përfshirë edhe</p>

<p>rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>sugjerimet konkrete për ndryshimet që duhen bërë apo jo në vitin pasardhës.</p> <p>Detyrimet përmbyllëse të çdo lënde apo moduli, u bëhen të ditur studentëve nga titullari i lëndës (<i>Evidenca II.7</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Personeli akademik ka në fokus të veçantë zhvillimin e kompetencave praktike të studentevë. Nga shqyrtimi i syllabuseve (<i>Evidenca II.7</i>) dhe nga biseda me studentë të këtij program studimi, rezulton se ka një përqindje të madhe orëve të karakterit praktik, apo zbatimit të metodave interaktive dhe aktiviteteteve nga pedagogët në klasë, duke krijuar klimën e përshtatshme për pjesëmarrje të studentëve dhe mbështetjen e ideve inovative.</p> <p>Po ashtu, personeli akademik inkurajonte studentët të merrin pjesë në konferenca dhe të publikonin punimet e tyre në revista shkencore nën mentorimin e pedagogëve. Studentët këshilloheshin nga pedagogët e tyre në lidhje me pjesëmarrjen në projekte apo punime konferencash (<i>Evidenca I.10</i>).</p> <p>Pasqyrimi i të gjitha aktiviteteteve të realizuar dokumentohej në Raportin semestral të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes (<i>Evidenca III.10</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit konfirmojmë se gjatë gjithë vitit akademik 2022-2023 personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi”, ka realizuar orë mësimore të hapura të cilat kanë patur në fokus zhvillimin e aktiviteteteve ekstrakurrikulare (<i>Evidenca III.9</i>).</p> <p>Rezulton se FSHSH dhe DEA përdorin një larmishmëri aktivitetesh të cilat përfshijnë jo vetëm mësimdhënien në auditore, por edhe veprimtari të tjera ekstrakurrikulare. Kështu, për vitin akademik 2022-2023, DEA ka zhvilluar aktivitete të tilla si: vizita të ndryshme studentore (në Bibliotekën Kombëtare, në Ekspozitën “Udhëtarët francezë në Ballakan dhe</p>

	Orient”, në Kryegjyshitën Botërore Bektashiane), leksione të hapura, promovim libri dhe konferencën studentore (<i>Evidenca III.9</i>).			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga takimi me drejtues të fakultetit dhe me studentë rezultojnë se Albanian University organizon rregullisht konferenca, trajnime, leksione të hapura, seminare apo trajnime profesionale duke inkurajuar përfshirjen e studentëve në të tilla aktivitete (<i>Evidenca II.14; I.10; III.6</i>). AU mbështet financiarisht çdo vit “Konferencën studentore” të organizuar nga bashkëpunimi i FSHSH, DEA dhe i departamenteve të tjera (<i>Evidenca I.10</i>).			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se përfshirja e studentëve në veprimtaritë akademike dhe shkencore të fakultetit është një aspekt i rëndësishëm që garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Në rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil . “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe . “Menaxhim Arsimit” (<i>Evidenca II.2, nenet 32, 33, 34, 35</i>) dhe në Rregulloren e Departamentit (<i>Evidenca II.3, neni 23</i>) janë të përcaktuara të gjitha procedurat lidhur me detyrimet përmblyëse, provimin e diplomimi/përgatitjes dhe mbrojtjes së një teme diplome, e deri tek dhënia e diplomës. Për shembull, studentët e këtij program studimi i nënshtrohen provimit të diplomit ose ata me mesataren mbi 8.7 përgatisin një temë diplome.

	<p>Biseda me stafi akademik dhe me studentët e këtij program studimi, konfirmoi se raporti i studentëve që përzgjidhnin të jepnin provimin e formimit me ato që e mbronin përmes një punimi dilome, ishte 70% me 30%.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit dhe të rregulloreve të studimit, konfirmohet se janë të përcaktuara qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tërë strukturave si akademike dhe administrative për të mbështetur studentët me informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme që lidhen me detyrimet mbyllëse apo diplomimin (<i>Evidencat II.2; II.3</i>).</p> <p>DEA për të ndihmuar studentët në drejtim të punimit të temës së diplomës ka vënë në dispozicion një manual udhëzimi “Si të shkruajmë një temë diplome” (<i>Evidenca III.11</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Procedurat për ngritjen, përbërjen dhe funksionin e komisionit të posaçëm të provimit final, janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Departamentit të Edukimi dhe Anglishtes, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil . “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe . “Menaxhim Arsimi”. “Ky komision është i përbërë nga 3-5 veta të stafit akademiki cili është i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi dhe e njeh ata më së miri. ... Provimet e formimit organizohen në bazë të dhënash me pyetje formimi mbi grup lëndët e formimit karakterizues” (<i>Evidenca II.3, neni 23</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga bisedat në institucion, konfirmojmë se udhëheqësi i temës së diplomës monitoronte punën e studentit që në fillim të përzgjedhjes së temës e deri në mbrojtje të saj përpara jurisë. Në fillim të viti akademik, DEA përcaktonte grup-temat për studim nga studentët për atë vit akademik bashkë edhe me pedagogët udhëheqës. Plani i diplomimit shpjegohej shumë qartë në <i>Manualin për punimin e diplomës</i> dhe ishte pjesë përbërëse e prezantimit në fillim të vitit akademik nga stafi dhe përgjegjësi i departamentit. Udhëheqësi shkencor garantonte cilësinë e rezultateve dhe miratonte ose jo temën e përfunduar të diplomës së studentit. Ishte detyrë e udhëheqësit të temës së diplomës të përgatiste edhe një relacion vlerësimi me shkrim mbi tezën e punuar nga studenti lidhur me origjinalitetin, pikat e forta dhe të dobëta të tezës, etj. (<i>Evidenca III.11</i>).</p>

për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqësi i temës së diplmës është pjesë e stafit të kualifikuar me grada e tituj të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes. Ai asiston studentin në kryerjen e matjeve të ndryshme, analizave dhe në shkrimin e temës së diplomës sipas gjithë udhëzimeve të miratuara nga DEA (<i>Evidenca III.11</i>).
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit përfundimtar/mbrojtje të diplomës, studentit vlerësohet me notë me vlerësim autonom nga secili anëtar i komisionit. Nota përfundimtare përbën mesataren e vlerësimit të dhënë nga secili anëtar i komisionit. Nota përveç sistemit kombëtar të vlerësimit, përcaktohet edhe në sistemin evropian ECTS (sistemi me germë) (<i>Evidenca III.11, pika 7/c</i>).
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Rezulton nga dokumentacioni i verifikuar në sekretarinë mësimore se studentit pajiset pas përfundimit të detyrimeve mbyllëse me diplomë, suplementin e saj dhe me listën e notave të lëshuara nga Albanian University. Ky veprim parashikohet edhe në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore (<i>Evidenca III.13, neni 12</i>). Nga verifikimi i diplomës rezulton se diploma ka të gjitha elementët e përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Rregullorja e studimit e njësisë kryesore (<i>Evidenca III.12.a.b.c</i>).
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e informacionit të studentëve ndër vite, ish-in Sekretaria mësimore e programit të studimit, Kryesekretarja e FSHSH-së dhe Administratori i përgjithshëm. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë mësimore rezultoi se në përputhje me ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008, për mbrojtjen e të dhënave personale, kjo njësi ndihmëse administrative arkivonte dhe mbante në dosje për çdo student dokumentacionin përkatës që nga rregjistrimi, ç'rregjistrimi (nëse ka) dhe deri në diplomimin e tij. Ky informacion vihet në dispozicion të studentit sa herë i kërkohet. Të gjitha të dhënat e studentëve gjendeshin në databaset e sekretarisë mësimore si dhe në regjistrat e notave.

Konkluzione	<p><i>GVJ konkludon se institucioni zbaton procedura të qarta lidhur me detyrimet permbyllëse të studentit në programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil . “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe . “Menaxhim Arsimi” dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm sipas gjithë udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përbushjes sëstandardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky program studimi zhvillon veprimtarinë e tij në Godinën qendrore, Bulevardi “Zogu I”. Nga vizita në AU, konfirmojmë se ambientet fizike dhe infrastruktura e godinës janë të përshtatshme për mësimdhënie me salla leksionesh, salla konferencash apo aktivitete të tjera informuese. Të gjitha sallat janë të pajisura me mjete audio-vizive, kompjuter personal, video-projektor, sistem fonie, internet dhe wireless. Marrëveshjet e FSHSH dhe DEA-s me institucionet e arsimit parauniversitar bëjnë të mundur zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në mjediset e këtyre shkollave.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ku program studimi është Master Profesional në “Pedagogji” me profile, i përket fushës së arsimit ndaj ky kriter nuk zbatohet.

<p>Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Sipas planit mësimor, Praktika për të dy profilet e këtij program studimi, vlerësohej me 6 pikë kredite (ECTS) (Tabela 9.1; 9.2). Përfundimi i praktikës profesionale shoqërohej nga studenti me disa dokumente, që përfshinin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkresën zyrtare përcjellëse nga Zyra Vendore Arsimore; - Formularin e plotësuar nga mësuesi mentor mbi ecurinë e në praktikë të studentit; - 10 plane ditare të cilat studenti i ka zhvilluar si orë mësimi (Evidenca III.14). <p>Siç u konfirmua nga pedagogu mentor i praktikës profesionale gjatë vizitës në AU, kjo praktikë zhvillohej në institucionet e APU-së e grupuar për 4 javë rresht.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon që Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes, për këtë program studimi, kanë siguruar mjedise fizike dhe infrastrukturore komode dhe të përshtatshme për zhvillimin normal të mësimdhënies, si dhe planifikojnë sipas procedurave të qarta dhe organizojnë praktikat profesionale të studentëve në institucionet e arsimit parauniversitar, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit me këto institucione.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ ka analizuar dokumentacionin të paraqitura në evidencë, si dhe CV-të e personelit akademik, dhe ka konstatuar se personeli akademik i përmbush kërkesat ligjore në fuqi, në departamentin e Edukimit dhe Anglishtes, Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Albanian University.</p> <p>Aktualisht, njësia bazë, përgjegjëse e programit të studimit, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, në të cilin ushtrojnë veprimtarinë e tyre 18 lektorë, prej të cilëve 9 janë personel akademik efektiv (PAE) nga ku: 1 ka gradën Prof. Dr., 2 Prof. i Asociuar dhe 6 kanë gradën Dr., dhe 9 janë personel akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Kjo njësi vepron në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, për sa i përket ngarkesës mësimore sipas titujve akademik dhe profileve të studimit të tyre, për programet Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’. Raporti i pedagogëve PAE/PAK të angazhuar në programin e studimit që po vlerësojmë, është 5 me 5</p> <p>PAE 1 Prof.As dhe 4 Dr: PAK 2 Prof .As (Evidenca, Aneks Prof.Dr dhe 2 Dr RBV, Tabela 6).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik në bazë të marrëveshjes për kohën e punës vjetore të personelit mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë.</p> <p>Në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’, si disiplinat e formimit bazë, karakterizues, ndërdisiplinor, si dhe disiplinat plotësuese janë tërësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njesisë Kryesore (Evidenca, Aneks RBV, Tabela 6 dhe Tabela 12).</p> <p>Respektivisht, lëndët me profil pedagogjik dhe teoriko-metodologjike mbulohen nga stafi i brendshëm i departamentit,</p>



	<p>i cili mbulon 70% të ngarkesës mësimore (<i>Evidenca 2,4</i>). Ndërsa lëndët me profil psiko-sociale dhe të tjera, mbulohen nga stafi me kohë të pjesëshme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Personeli akademik nënshkruajnë kontratën me ‘Albanian University’, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Personeli akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar, është i pandryshueshëm për të gjithë periudhën e parashikuar për akreditim në programin Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’. - Personeli akademik me kohë të pjesëshme, për vetë natyrën specifike të këtij programi, përgjithësisht, është i pandryshueshëm për të gjitha vitet akademike të parashikuara në akreditim. <p>Institucioni garanton dhe të dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, si dhe qëndrueshmërinë dhe detyrimet financiare (<i>Evidenca, II.11</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ndjek procedurat rekrutimi dhe vlerësimi sipas kritere të përgjithshme dhe specifike (<i>Evidenca, IV.2.a</i>). Të gjitha njoftimet publikohen duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen si dhe kërkesat e programit të studimit (<i>Evidenca, IV.2.b</i>).</p> <p>Nga vizita e GVJ-së në institucion dhe zyrat e BNJ-së, në periudhën kohore që është aktivizuar programi i studimi Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’, procedurat e rekrutimit, janë të fokusuar në kriteret e përgjithshme dhe ato specifike (<i>Evidenca IV.1</i>).</p> <p>-Kriteret e përgjithshme hartohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.</p> <p>-Kriteret specifike parashikohen në Njësinë bazë, Departamenti i Interpretimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të</p>	<p>Programi, Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’, nuk ka orë laboratorike dhe nevoja specifike për realizimin e orëve në laborator.</p>



<p>përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Albanian University, mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së, konsatohet se të dhënat mblidhen, ruhen dhe përditësohen për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, - angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, - angazhimin e çdo anëtari të personelit ndihmës dhe administrativ. - Personeli akademik me kohë të pjesshme dhe afat të caktuar, aplikon çdo fillim viti akademik. - Kriteret e konkurrimit shpallen publikisht sipas legjislacionit në fuqi (<i>Evidenca, Aneks RBV, Tabela 12</i>).
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të</p>	<p>Duke u bazuar në marrëveshjet për praktikat profesionale me shkolla, Albanian University, vë në dispozicion personelin e duhur për ndjekjen e praktikave.</p> <p>Studentët e programit të studimit Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’, në përputhje me parashikimet e planit mësimor dhe në mbështetje të lëndëve specifike të mësuesisë, duhet të realizojnë praktikat mësimore pranë institucioneve të ndryshme që gjenden në listën e përcaktuar në dokumentacion (<i>Evidenca, II.14</i>).</p>




tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.									
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Albanian University ka marrëveshje bashkëpunimi me ZVA për praktikat profesionale ku praktikat mësimore studentët i realizojnë në shkolla. Marrëveshja parashikon angazhimin e një pedagogu, përfaqësues të njësisë bazë në mbikëqyrjen e praktikës, si dhe një përfaqësues të institucionit pritës. Përfaqësuesi i institucionit pritës mbikëqyr dhe ndihmon studentin gjatë zhvillimit të praktikës, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar. Në përfundim të praktikës, përfaqësuesi i institucionit pritës, jep vlerësimin e tij për çdo student të mbikëqyrur (<i>Evidenca, II.14</i>).								
Konkluzione	<i>GVJ, konstaton se, personeli akademik efektiv dhe me kontratë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, Drejtoria e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik, si dhe realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës.</i> <i>GVJ, konstaton se Albanian University e përmbush plotësisht këtë standart.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin	Gjatë vizitës së hapësirave fizike në Albanian University, GVJ konstaton se ka hapësira të mjaftueshme për mësim/leksionet. Institucioni siguron mjediset specifike për orët e leksioneve me një numër jo të madh dhe mjediset për mësim në grupe të mëdha.

<p>e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Auditorët dhe sallat janë të pajisura me mjete teknologjike, të cilat ndihmojnë në procesin e arsimit bashkëkohor (<i>Evidenca ,IV.3).</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës së ambienteve fizike në Albanian University, GVJ konstaton se ka hapësira të mjaftueshme dhe adekuate për mësim të studentëve. Auditorët e lëndëve teorike janë të pajisura me mjete elektronike dhe pajisje teknologjike. Mjediset mësimore të Albanian University biblioteka, laboratorit i informatikës dhe sallat e leksioneve, nëpërmjet të cilës realizohet procesi mësimor teorik janë të pajisura me kompjutera laptop, desktop, monitor dhe projektor. Nëpërmjet përdorimit të teknologjive bashkëkohore garantohet përdorimi i metodologjive të mësimdhënies e mësimnxënies bashkëkohore.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës së ambienteve fizike në Albanian University, GVJ konstaton se ka hapësira të mjaftueshme dhe adekuate për mësim dhe leksionet e studentëve.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstaton se në godiën ku zhvillohen leksionet e programit të studimit Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimit’, gjendet një laborator informatike, me pajisjet e duhura për tu përgjigjur kërkesave të studentëve dhe stafit. Asistimin e këtij laboratorit IT, e mundëson personi përgjegjës me profil IT.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas</p>	<p>Gjatë vizitës së ambienteve fizike në Albanian University, GVJ konstaton se ka hapësira për mësim dhe leksione të studentëve në laboratore të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Laboratori i Informatikës përmban mjetet e teknologjisë së informacionit bashkëkohore për një mësimdhënie efektive. Institucioni ka siguruar një laborator të teknologjisë së</p>



natyrës së programit të studimit që ofron.	informacionit të pajisur me programe software të instaluar në kompjuterat që gjenden në këtë laborator janë të licënuara, ku përfshihen Paketa Office, Exel, Word etj.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	<p>Bazuar në dokumentet e paraqitura në evidencë, institucioni ka marrëveshje me institucionet për kryerjen e lëndëve të pedagogjike dhe menaxhim arsimit.</p> <p>Nga vizita GVJ-së, në ambientet fizike në institucion, konstatohet se institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për profilin e departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit të ciklit të dytë studimit Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimit’, për realizimin e praktikave profesionale praktike, si dhe veprimtarive të tjera praktike e realizojnë sipas orarit mësimor (<i>Evidenca, Aneks RBV, Tabela 5</i>).</p>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për zhvillimin e lëndëve specifike të këtij programi studimi, si dhe përmbushur plotësisht këtë standart.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në bibliotekë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, e cila është pjesë e bibliotekës së Albanian University, zotëron portalin portal.getty.edu, i cili ofron rreth 100.000 volume librash të vëna në dispozicion nga një sërë universitetesh në mbarë. Gjithashtu, biblioteka online është pasuruar edhe me platformën online, elsevier.com ku ofrohen 46 907 tituj librash dhe 2221 gazeta (https://albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka-online/).</p> <p>Pavarësisht se fondi i bibliotekës së universitetit Albanian University, në godinën që gjendet te Zogu I, ka rreth 5107 librash të cilët janë libra mësimorë, manuale, artikuj simpoziumesh, fjalorë, revista të ndryshme si dhe artikuj të ndryshëm gazetash të Universitetit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka/). Kjo bibliotekë ka të skeduar 1538 tituj nga të cilët 235 tituj janë literaturë në gjuhë të huaj. Gjatë vizitës së GVJ-së në ambientet e bibliotekës së Fakultetit të Shkencave Shoqërore, konstatohet se ka një numër relativisht të vogël botimesh të printuara, rreth 2000 kopje, specifikisht mbulon vetëm nevojat e litreaturës kryesore të departamentit të Edukimit dhe Anglishtes (<i>Evidenca, IV.5</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ-së, në ambientet fizike të Albanian University, si dhe nga analizimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet se njësia bazë bën raportime në lidhje me përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit.</p> <p>Fondi i bibliotekës pasurohet me literature bashkëkohore duke marrë në konsideratë sygjerimet e stafit akademik për titujt dhe fusha të veçanta apo specifike të studimit (<i>Evidenca, IV.4</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Shoqërore konstatohet se personelit administrativ punon me përkushtim për të ofruar studentëve shërbimet e duhura. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore të librave të printuar ose librarive elektronike, duke garantuar mundësinë e përdorimit nga të gjitha programet e studimit (<i>Evidenca, IV.5</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së në ambientet fizike, konstatohet se biblioteka e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, përmban materiale të shumëllojshme si: libra, gazeta, revista, dizertacione, mikro-teza, materiale software etj. Një pjesë e këtyre botimeve, mbulojnë kërkesat e literaturës kryesore të departamentit, specifikisht të programit studimit Master</p>



<p>apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’, por duhet të pajisen me botime të tjera të këtij profili, për të përmbushur edhe kërkesat e literaturave ndihëmes të lëndëve përkatëse (<i>Evidenca, IV.4</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Në bibliotekën e Albanian Universityë ka 309 vende leximi si dhe biblioteka është e pajisur me kompiutera në ndihmë të lexuesve. Ndërsa në bibliotekën e Fakultetit i Shkencave Shoqërore, gjenden një numër i konsiderueshëm i kompjuterave (<i>Evidenca, IV.4</i>).</p> <p>Nga vizita e GVJ-së, konstatohet se institucioni garanton e krijon kushte optimale për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita e GVJ-së, konstatohet se Albanian University, në bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, ka realizuar procesin të dixhitalizimit dhe platformave të ndryshme për aksesim online.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së, konstatohet se ambientet e bibliotekës së Albanian University, vihen në dispozicion të plotë të studentëve (me orar 8:00-16:00), në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor (edhe për studentët e programit të nivelit të dytë) (https://albanianuniversity.edu.al/sq/biblioteka/).</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së, konstatohet se personeli administrative i bibliotekës raportojnë periodikisht për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, nivelin e shfrytëzimit dhe përdorimit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët po ashtu raportojnë edhe për</p>

<p>shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>shfrytëzimin e sallave. Në mënyrë periodike raportohet lidhur me cilësinë e fondit fizik.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni, ka kapacitetet e duhura infrastrukturore për bibliotekën, por për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në Pedagogji, me profil 'Mësuesi në Arsim Fillor' dhe 'Menaxhim Arsimi', ka relativisht mjaftueshmëri për plotësimin e literaturave ndihmëse.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, sipas GVJ, institucioni e përmbush kryesisht këtë standart.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit por edhe nga vizita në ambientet fizike të institucionit, GVJ konston se Albanian University, disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Numri i studentëve të regjistruar në vitin akademik</p>



<p>tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>2022-2023 për programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profile: “Mësuesi në Arsim Fillor” është 20 studentë (18 + 2 të transferuar), dhe</p> <p>“Menaxhim Arsimi” është 17 studentë (16 + 1 të transferuar</p> <p>Sistemi Pitagora, i ofruar prej RASH, mundëson funksionalitetet e nevojshme tek sekretaritë, administrata, ashtu si dhe përdoruesve (studentëve, stafit akademik, etj.), në mënyrë që të menaxhojë të gjithë ciklin akademik të studentit: si regjistrimi në syllabuset e kurseve, transferimet nga njëri universitet në tjetrin vlerësimet dhe diplomimet (http://au.pitagora.rash.al).</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve PITAGORA në Albanian University, zbatohen politika të ruajtjes së të dhënave dhe përpilimi të statistikave me të dhënat e studentëve nga ana e sekretarisë mësimore si dhe regjistrave fizik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konsaton se, për anën akademike, sistemi PITAGORA administron informacion dhe aktivitetin e lektorit, konkretisht në hedhjen e frekuentimeve të lëndëve/moduleve për studentët ndjekës të programit të studimit, sipas grupit dhe kursit përkatës.</p> <p>Ndërsa për anën administrative, sekretaria mësimore, ruan informacionet rreth pranimit dhe regjistrimit të studentëve, menaxhimit të dhënave për studentët që do të diplomohen, si dhe ruajtjen dhe arkivimin e provimeve, notave etj (<i>Evidence, II.13</i>).</p> <p>Marrëveshja e Konfidenialitetit, zbatohet tërësisht, nëpërmjet ruajtjes së anonimitetit dhe dhënies së informacioneve të personat e paautorizuar (https://albanianuniversity.edu.al/sq/politikat-e-privatesise-te-albanian-university/).</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Albanian, siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë studentët dhe personelin akademik duke përdorur emailin e postave nga Sekretaria Mësimore si dhe sistemin PITAGORA, i cili siguron akses në informacionet dhe dokumentet, për personelin akademik dhe administrative (<i>Evidenca, II.13</i>).</p>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në Sistemin e Menaxhimit të Studentëve PITAGORA, titullari i lëndës dhe studentët mund të realizojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit.</p> <p>Gjithashtu, nga vizita e GVJ-së në institucion, vihet re se, komunikimi interaktiv midis stafit (akademik dhe administrative) dhe studentëve realizohet nëpërmjet platformës Microsoft Team, adresave të postës elektronike zyrtare që institucion vë në shërbim të stafit dhe studentëve (<i>Evidenca, II.13</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ konstaton se, Sistemi i Menaxhimit të Studentëve, PITAGORA, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit të personelit akademik, ku frekuentimi i lëndëve, vendosja e notës nga lektori, i'u transmetohet studentëve në adresat elektronike të tyre.</p> <p>Procesi i ngarkimit të lëndëve/moduleve, lista e studentëve pjesëmarrës në provim etj, nga Sekretaria Mësimore, përcillet automatikisht direkt në sistemin e menaxhimit të titullarit të lëndës.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstato se, në faqen zyrtare të Albanian University realizon publikimin e informacioneve që lidhen me programin e studimit, me personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme (https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/njoftime-sq/)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe në evidencat, konstaton se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet sistemit PITAGORA, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre.</i></p> <p><i>Konstatohet se, institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të web-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara duke përmbushur plotësisht këtë standart.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, i cili ofrohet programin Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimit’, realizon planin vjetor për mbështetje financiare dhe raport financiar të kostos së njësisë bazë si dhe projekt buxhetet 3 vjeçare.</p> <p>Metodologjia e hartimit të raportit financiar të kostove të njësisë bazë analizon të dhënat e kostove të programit të këtij studimit në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Personelin akademik me kohë të plotë, - Personelin akademik me kohë të pjesshme; - Shpenzime të stafit të Sekretarisë Mësimore, - Shpenzime te baza materiale didaktike, - Shpenzime të tjera (energji, ujë, etj) dhe amortizim vjetor, <p>Projekt buxhetet dhe kriteret e tij, vendosen nga Bordi Administrues, duke qenë se institucioni është IAL jo publike (<i>Evidenca, VI.11</i>).</p>



<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe</p>	<p>Plani i financimi të përbashkët të të gjithë strukturës universitare, është vet Albanian University. Për programet e studimit, detajimi i planit financiar, realizohet duke marrë në konsideratë kërkesat dhe nevojat njësisë bazë (<i>Evidenca, I.2.a</i>). Në buxhetin e Albanian University, specifikisht të departamentit të Edukimit dhe Anglishtes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - grantet për mësimdhënien dhe funksionimin, - grantet për kërkim dhe publikime - shpenzime për projekte shkencore, - të ardhurat, etj. <p>Të gjitha, janë të miratuara sipas vendimeve të Senatit dhe Bordit të Administrimit (<i>Evidenca, I.2.b</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Albanian University, mund të auditohet periodikisht sipas akteve ligjore në fuqi, nga institucione përkatëse të auditimit (ministria etj) (<i>Evidenca, I.2.a</i>). Institucioni nënshtrohet vazhdimisht auditimit periodik të bazuar mbi dokumentacion për gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar, sic është edhe në raportin e Auditit (<i>Evidenca, I.2.b</i>).</p> <p>Nga vizita e GVJ-së, konstatohet se Albanian University, zotëron njësinë administrative, Zyrën e Auditit të brendshëm. Institucioni gjithashtu, i nënshtrohet auditit vjetor, të realizuar prej kontabilistit i miratuar, për të mbajtur balance dhe drejtuar Bordit të Administrimit, i cili sipas raportit mundëson hartimin e politikave për vitin të ardhshëm.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Albanian University raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p> <p>GVJ konstaton se raportimi i institucionit përmban të dhëna për:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Të dhëna të përgjithshme mbi Albanian University, lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj. b) Planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit.



	<p>c) Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik etj.</p> <p>d) Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore (<i>Evidenca, I.2.b</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë, Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes, dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, duke u bazuar në Ligjet në fuqi dhe planet për mbështetje financiare për programet e studimit. Gjatë viteve të fundit buxheti i institucionit ka qenë i mjaftueshëm dhe ka garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen me sukses të programit të studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion dhe në evidencat, GVJ konstaton se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p> <p><i>GVJ, konstaton se Albanian University përmbush plotësisht këtë standart.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Albanian University, harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë të studimeve, në rastin konkret, programet e nivelit të dytë të studimit, specifikisht Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’,</p> <p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore, në Albanian University, e zhvillon veprimtarinë e tij, bazuar në ‘Rregulloren e Përgjithëshme të Albanian University’, ‘Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Shoqërore’ (<i>Evindeca: I.5</i>), si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’.</p> <p>Bazuar në ‘Rregulloren e Studimit, Të fakultetit të Shkencave Shoqërore’, e miratuar në datën 03/54/2017, nr.31, mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 datë 22/07/2015 ‘Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë’, i miratuar nga Senati Akademik i Albanian University. Në kreun 4, Organizimi dhe Funksionimi i Studimeve Universitare, paraqet procedurat dhe veprimtarinë akademike në programet e e studimeve.</p> <p>Rregullorja paraqet qartë, kushtet dhe procedurat ndërprerjes së studimeve (kreu 39), mbarëvajtjen dhe mësimdhënien (Kreu 40, etj) (<i>Evidenca, I.3</i>).</p> <p>Një element i rëndësishëm për tu përmendur, është edhe qartësia e rregullores së Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’, e cila paraqet kontrollit të dijes dhe njohurive, mbarëvajtjen e sistemit të provimeve dhe vlerësimit, që gjenden në Kreun 5, Vlerësimi i Studentëve (Kreu 5, Neni 19-24) (<i>Evindeca, II.2</i>).</p> <p>Gjithashtu, Programi i ciklit të dytë, në Rregulloren e Programit të Studimit Master Profesional në Pedagogji, me profil</p>

	<p>'Mësuesi në Arsim Fillor' dhe 'Menaxhim Arsimi', zbaton rregulloren e programeve të ciklit të dytë, të miratuar me vendim Senati Akademik, Nr 31 datë 20/04/2022, cila përmban detaje rreth objektivave, qëllimit të studimit, formës së matjes së njohurive, sezonet e provimeve, praktikat profesionale, diplomimin etj.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e Përgjithëshme të Albanian University, (të cilat janë realizuar duke u mbështetur në ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe miratuar nga Senati Akademik) si dhe në rregulloren e Master Profesional në Pedagogji, me profil 'Mësuesi në Arsim Fillor' dhe 'Menaxhim Arsimi', paraqet në kreun 3, pranimin e studentëve dhe kriteret e pranimit, në kreun 4, drejtave dhe detyrimeve të studentit, që përfshihet satusi i tij, etika dhe sjellja (<i>Evidenca, I.3</i>) dhe (<i>Evindeca, II.2</i>).</p> <p>Politikat e strategjive që gjenden në Plani Strategjik 2023-2028 (pika 3 dhe 4), dhe rregulloret e Universitetit dhe programit të ciklit të dytë, paraqesin garantim të barazisë dhe të drejta të barabarta për të gjithë studentët (<i>Evidenca, I.2.b</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Fakulteti publikon cdo vit kriteret e miratuar për pranimet në programin Master Profesional në Pedagogji, me profil 'Mësuesi në Arsim Fillor' dhe 'Menaxhim Arsimi' në faqen zyrtare inline, të universitetit si dhe afishimet në ambientet e përcaktuara për lajmërimi.</p> <p>Faqja zyrtare online, në rubrikën Kreu, paraqet njoftime të përditësuara me fokus studentët (duke zbatuar kalendarin e paraqitur nga MAS, për ndjekjen e procedurave të regjistrimeve për studentët e rinjë) për regjistrimet, si dhe veprimtarive të ndryshme që realizohen në këtë institucion (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kreu/).</p> <p>Institucioni bashkëpunon me DAR/ZA, Shkollat e Mesme të Përgjithshme dhe Jo Publike për informimin e maturantëve me programet e studimit që fakulteti i Shkencave të Edukimit ofron. Fakulteti informon maturantët si student të ardhshëm përmes faqes zyrtare online, njoftimeve në rrjetet sociale, njoftimeve e informacioneve në ambientet e Fakultetit si dhe nëpërmjet publikimit të guidës së Fakultetit të Shkencave të Edukimit të Shkencave Shoqërore.</p>



<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nëpërmjet platformës online, si dhe informimet nga zyrat përkatëse, të gjithë maurantët ose aplikuesit e interesuar, informohen për procedurat e pranimit, përzgjedhjes, të transferimit apo dhe të aplikanteve që dëshirojnë të studojnë si program të dytë studimi për departamentin dhe programin përkatës mbështetur ne aktet ligjore në fuqi dhe në udhëzimet e MASR.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së, konstatohet se në fillim të çdo viti akademik Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në bashkëpunim me Dekanatin e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, organizon takim me studentët e rinj për t'i informuar rreth procedurës së vlerësimit të dijeve si dhe për procedurat e diplomimit mbështetur në Rregulloren e Albanian University si dhe i pasqyron ato në faqen zyrtare online.</p> <p>Gjithashtu, në rregulloren e programeve të ciklit të dytë, paraqitet qartë transferimet e studimit, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit. Nga vizita në institucion, konstatohet se rregulloret janë të printuara dhe të afishuara në ambientet fizike të institucionit, ku studentët kanë akses të lehtë siç është sekretaria mësimore dhe zyra e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Platforma online, përmban sesionin e njoftimeve, ku institucioni informon publikun dhe të gjithë të interesuarit në lidhje me kriteret e përgjithëshme dhe të veçanta (specifikisht kurrikulat dhe shpërndarjen e ngarkesës së çdo lende, të ndarë në semestra), të çdo program studimi, specifikisht të program Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimit’.</p> <p>Përpara çdo viti akademik Institucioni harton, miraton dhe publikon kriteret e përgjithëshme dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve në këtë program (<i>Evindeca, II.2</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të</p>	<p>Albanian University, bazohet në kriteret e përgjithshme që janë të përcaktuar nga dispozitat ligjore të arsimit të lartë dhe aktet nënligjore të ndërtuara nga Ministria e Arsimit, për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta dhe ndryshe, të pakicave dhe grupeve të marginalizuara. Politikat dhe strategjitë që ky institucion harton dhe zbaton janë sa specifike</p>




veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>aq edhe të përgjithëshme (bazohen në aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit, për grupet e veçanta).</p> <p>Kjo paraqitet në faqen zyrtare online si Vendimi i Senatit akademik për kapacitetet për vitin akademik përkatës, për kuota të posaçme dhe kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/).</p>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Albanian University, bazohet në kriteret e përgjithëshme që janë të përcaktuar nga aktet nënligjore të ndërtuara nga Ministria e Arsimit, për përzgjedhjen e kandidatëve nga trevat dhe shtetet e ndryshme (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/).</p>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Albanian University, në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse të ndihmës dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas vendimit të Bordit të Administrimit.</p> <p>Niveli i lartë i rezultateve të studentëve, si nga mesatarja e shkollave të mesme, qoftë nga rezultatet e larta të përfituara në vitin e parë akademik, u mundëson të gëzojnë të drejtën e bursave. Hartimin e politikave të bursave, institucioni e ka në përputhshmëri me ligjin e arsimit të lartë (https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/).</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se, nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucionin, Albanian University e përmbush plotësisht këtë kriter.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në	Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, të Albanian University si dhe Rregullore e Programit të studimit Master Profesional në Pedagogji, me profil 'Mësuesi në Arsim Fillor'

<p>lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>dhe 'Menaxhim Arsimi', disponojnë informacion të qartë dhe të plotë për studentët rreth procedurave të përparimit të vitit akademik dhe detyrimet për të kaluar në një tjetër vit akademik.</p> <p>Gjithashtu, faqja zyrtare online e Albanian University, ofron informacionin e duhur për studentët për kriteret, procedurat dhe datat (kalendarin akademik të vitit përkatës), orarin, e fillimit të studimeve në programin e me profil 'Mësuesi në Arsim Fillor' dhe Menaxhim Arsimi' (https://albanianuniversity.edu.al/sq/orari-mesimor/).</p> <p>Studentët informohen edhe me postë elektorinike në adresat elektronike të tyre. nëpërmjet sistemit PITAGORA për vlerësimin e tyre nga stafi akademik dhe ofron mundësi të komunikimit të drejtpërdrejtë të tyre.</p> <p>Institucioni disponon edhe informacionin në ambientet e përcaktuara, të njoftimeve për secilin fakultet.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e Rregulloren e Programit të studimit Master Profesional në Pedagogji, me profil 'Mësuesi në Arsim Fillor' dhe 'Menaxhim Arsimi', paraqitet qartë informimi për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme (<i>Evidenca, 11.6</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Albanian University, nëpërmjet rregullores, lajmërimeve në vendin e përcaktuar në ambientet e çdo fakulteti përkatës, në syllabuset e lëndëve të prezantuar në auditor, dhe nëpërmjet lançimit të syllabuseve dhe mënyrës së vlerësimit në faqen zyrtare online, i informon studentët për procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive që do të përvetësohen në lëndët që ata do të frekuentojnë (<i>Evidenca, 11.6</i>).</p> <p>Lektori përgjegjës i lëndës/ modulit në orën e parë të Seminarit Orientues njih studentët me kriteret e lëndës dhe vlerësimin e tyre (<i>Evidenca, 11.8</i>).</p> <p>Institucioni e paraqet informacionin nëpërmjet disa lloje kanalesh komunikimi, si të afishuar, online dhe nëpërmjet stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	<p>Albanian University, në rregulloren e ciklit të dytë të programeve të studimit, për diplomimin, përcakton qartë modalitetet e diplomimit, zgjedhjen dhe ndryshim e udhëheqësit, ndryshimin e temës së diplomës, përgatitjen dhe organizimin e</p>



<p>punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>mbrojtjes së diplomës (në dy forma, teorike të paraqitur me format të printuar (mikro teza) dhe me provim), si dhe vlerësimin e saj (<i>Evidenca, I.2.b</i>). Kjo rregullore ndodhet e printuar edhe në ambientet e departamentit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konston se, zhvillohet një komunik i vazhdueshëm dydimensional, midis studentëve, përgjegjësit të departamentit, si dhe stafit akademik. Departamenti përgjegjës informon studentët lidhur me kriteret e procedurat e punimit të diplomës/provimit përfundimtar të formimit për diplomimin në programin e studimit Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’ duke publikuar në faqen zyrtare online datën e fillimit e mbarimit të procesit dhe materialin e nevojshëm për përgatitjen e detyrimeve përmbyllëse të programit të studimit bëhet nëpërmjet Pedagogut mentor. Gjithashtu, studentët njihen me Manualin e Punimit të Diplomës, nga shefi i të miratuar nga institucioni, departamentit, faqja zyrtare online, dhe pedagogu mentor (<i>Evidenca, II.11</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Albanian University, organizon takime në ‘Ditët e hapura’ për informimin e maturantëve për programin e studimit. Fakulteti informon studentët e ardhshëm nëpërmjet njoftimeve në faqen zyrtare online, në rrjetet sociale, njoftimet e informacionet e vendosura në stendat e në ambientet e Fakultetit të Shkencave Shoqërore.</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, realizon komunikime të vazhdueshme me Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, Shkollat e Mesme të Publike dhe Jo publike, me qëllim të rris interesin e maturantëve për të vazhduar studimet në programet që ofron Fakulteti i Shkencave shoqërore, specifiksiht departamenti Edukimit dhe Anglishtes.</p> <p>GVJ konstaton se stafi akademik i departamentit Edukimit dhe Anglishtes, merr pjesë në ditët e hapura dhe panairt e organizuara nga MASR me qëllimin për informimin publik në bashkëpunim kur maturantët janë në periudhën e zgjedhjes së programeve të studimit.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se Albanian University, vë në dispozicion të plotë të studentëve të programit të studimit Master Profesional në</i></p>

	<p><i>Pedagogji, me profil 'Mësuesi në Arsim Fillor' dhe 'Menaxhim Arsimi', si dhe mundëson qarkullimin e informacionit të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit e tyre.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se, nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, Albanian University e përmbush plotësisht këtë kriter.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Albanian University, në fillim të vitit akademik, gjatë javë së parë, informon studentët për strukturën, planin mësimor, lëndët, provimeve për çdo semestër si dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Njoftimi realizohet nëpërmjet organizimit të takimeve informuese, afishimit të informacioneve të programit në stendat e fakultetit, në faqen zyrtare online, nëpërmjet publikimit edhe në rrjetet sociale.</p> <p>Gjithashtu, rregullore e ciklit të dytë të studimeve, specifikisht Master Profesional në Pedagogji, me profil 'Mësuesi në Arsim Fillor' dhe 'Menaxhim Arsimi', jep informacione të detajuara për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të nivelit të dytë të studimit.</p> <p>Ky informacion disponohet edhe nga zyra e studentit, si dhe nëpërmjet këshillimit me stafin akademik, përpara regjistrimit të studentit.</p> <p>Informacioni mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të universiteti (https://albanianuniversity.edu.al/sq/manifesti-akademik/).</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në faqen zyrtare online të Albanian University, paraqitet programi i studimit me lëndët që ka çdo program. Lëndët janë të përcaktuara në secilin semestër, me ngarkesën përkatëse dhe kategorizimin e tyre. Studenti i akseson të dhënat edhe nëpërmjet llogarisë të dedikuar të PITAGORA.</p> <p>Ndërsa, syllabuset e lëndëve, që prezantohen nga stafik akademik që zhvillohen lëndët, japin informacion të plotë për studentin për mënyrën se si janë të specifikuar lëndët dhe modulet mësimore, dhe veprimtaritë formuese të tyre. Ato përshkruajnë, temat, ngarkesën javore, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduara, format e kontrollit të dijeve etj (https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-shoqerore-2/).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë vizitës institucionale së GVJ-së në Albanian University, si dhe takimin me studentët, ata shprehen pozitivisht dhe ndiheshin të mbështetur dhe të motivuar prej stafit akademik, të cilët u kishin mundësuar lidhjet me institucionet ku një pjesë e tyre aktualisht ishin të punësuar (specifikisht në institucionet arsimore parauniversitare që zotëron kompania) (https://albanianuniversity.edu.al/sq/performance-akademike-e-studenteve-te-diplomuar-dhe-niveli-i-punesimit-te-tyre-ne-tregun-perkates-te-punes/).</p> <p>Tregues ky, që mundëson institucioni u jep mbështetje dhe orientim studentëve për tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Rregullore e Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’ paraqet një kre të veçantë, për informimin e studentëve, që nëpërmjet këshillit të studentëve, vendosin në dispozicion urën e informimit të vazhdueshëm (<i>Evidenca, I.2.b</i>).</p> <p>Departamenti mundëson zhvillimin e procesit mësimor në kushte të mira, për studentët, duke marrë në konsideratë karakteristikat e programit të studimit. Studentët kanë në dispozicion të gjithë logjistikën e nevojshme, ambjentet për realizimin sa më optimal të programit të studimit.</p> <p>Nga vizita e GVJ-së në institucion, konstatohet se stafi akademik duke kaluar shumë kohë në ambientet e institucionit, për punën akademike dhe për aktivitetet pedagogjike me</p>

	studentët, kanë një komunikim të vazhdueshëm dhe të harmonizuar.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Lehtësia në arritjen e komunikimit realizohet nëpërmjet: <ol style="list-style-type: none"> 1. Faqes zyrtare online të universitetit 2. Njoftimet e pedagogut për çdo lëndë. 3. Vlerësimet individuale nga pedagogu për çdo student dhe çdo vlerësim në praktikat. 4. Mundësi komunikimi online dhe offline mes studentëve dhe pedagogëve. 5. Mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit PITAGORA. Nga vizita institucionale e GVJ-së, konstatohet se studentët kanë komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik si dhe nëpërmjet sistemi të menaxhimit për qarkullimin e informacionit të brendshëm.			
Konkluzione	GVJ vlerëson se, <i>Albanian University</i> , përmbush plotësisht standartin V.3, sepse vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënies dhe mundësitë e punësimit, të cilat janë plotësisht të aksesueshme edhe në faqen zyrtare online. GVJ konstaton se, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, <i>Albanian University</i> e përmbush plotësisht këtë kriter.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për

Gjatë vizitës së GVJ-së në *Albanian University*, konstatohet se zyra e sekretarisë mësimore disponon të gjitha të dhënat e arritjeve akademike të studentëve, me regjistrat përkatës dhe


<p>numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>dokumentacionin e arkivuar. Kjo zyrë disponon statistika të çdo viti akademik, por edhe të pesë viteve të fundit të programit të Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’. Sekretaria Mësimore përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve PITAGORA si dhe regjistrave ruan të gjitha të dhënat statistikore (<i>Evidence, V.11</i>).</p> <p>Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve. Kjo njësi ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit.</p> <p>Numri i studentëve për 2022-2023 për programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profile: “Mësuesi në Arsim Fillor” është 20 studentë (18 + 2 të transferuar), dhe “Menaxhim Arsimi” është 17 studentë (16 + 1 të transferuar</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Albanian University, disponon të dhëna dhe përpilime statistikore për studentët e regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’. Këto të dhëna i disponon sekretaria mësimore përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve PITAGORA si dhe regjistrave. Paketa software PITAGORA mundëson një database të dhënash mbi studentët për këtë cikël studimi. Gjatë vizitës së GVJ-së në zyrën e sekretarisë mesimore, në Albanian University, konstatohet se informacioni rreth statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga program, largimet para diplomimit, ngrirjet e studimeve dhe përfundimi me sukses ose jo i programit të studimit, ishin të detajuara, regjistruara dhe arkivuara.</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në Albanian University, të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u prezantua me zyrën mësimore, e cila disponojti të dhënat zyrtare statistikore të pesë viteve të fundit të programit Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’ (<i>Evidenca, I.2.b</i>).</p>



<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Albanian University, disponon të dhëna dhe përpilime statistikore për studentët e regjistruar në programim e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’.</p> <p>Të dhëna i disponon sekretaria mësimore përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve PITAGORA si dhe regjistrave. Paketa softëare PITAGORA mundëson një database të dhënash mbi studentët për ciklin e studimit. Institucioni nëpërmjet zyrave përkatëse, vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse (<i>Evidenca, I.2.b</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në fund të vitit akademik Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, përgjegjës Master Profesional në Pedagogji, me profil ‘Mësuesi në Arsim Fillor’ dhe ‘Menaxhim Arsimi’, harton dhe raporton të dhëna analitike periodike mbi ecurinë dhe veprimtarinë mësimore të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me strategjitë e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve (<i>Evidenca, VI.11</i>).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se, Albanian University, përmbush plotësisht standartin V.4, për arsye se ruan të dhëna të hollësishme (i mbledh, administron dhe përditëson), në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Albanian University nxit dhe përfshin në diskutime dhe organizime, studentët dhe strukturat e tyre. Studentët përfaqësohen në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit siç janë: Senati, Këshillin Studentor si dhe grupe pune nëpërmjet kontributi që japin (sipas rregullores së organizmit dhe funksionimit) (https://albanianuniversity.edu.al/sq/keshilli-studentor/). Në Senatin Akademik të universiteti, ka përfaqësues edhe studentë të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, specifikisht nga departamenti i Eukimit dhe Anglishtes.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Albanian University garanton përfshirjen e studentëve dhe përfaqësinë e tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim mbi procesin akademik nëpërmjet përfaqësive të tyre në</p> <p>Studentët kanë të drejtë të jenë të përfaqësuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1-Senatin Akdemik; 2-Këshillin e etikës; 3-Komisionet e përherëshme të lejuara më statut; 4-Këshillat e studentëve. <p>Institucioni garanton përfshirjen dhe marrjen në konsideratë të mendimeve dhe poropzimeve të studentëve (https://albanianuniversity.edu.al/sq/keshilli-studentor/).Kjo konstatohet edhe në takimin me studentëve gjatë vizitës së GVJ-së, ku studentët ishin të angazhuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre, kanë përfaqësuesin e tyre në Komisionin Institucional Zgjedhor si dhe janë të përfshirë në procesin e vetëvlerësimit.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament,</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së konstatohet se njësitë bazë, departamenti i Edukimit dhe Anglishtes kanë komunikim dhe takime të vazhdueshme me studentët, për shkak të specifikës që zotëron. Në takimin e zhvilluar me studentët me GVJ-së, konstatohet se studentët ndihen të lirë dhe të hapur për të shprehur mendimin dhe dhënë kontributin e tyre në takimet, mbledhjet dhe aktivitetet akademike. Studentët janë pjesëmarrës edhe në mbledhjet e hapura në departament, në programet dhe aktivitete e ndryshme akademike që organizohen gjatë semestrit.</p>



me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.				
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në rregulloren e Përgjithëshme dhe të Programit të studimit, në Albanian University, paraqitet kontrolli i dijes, ku njihen të drejta të barabarta, pa asnjë ndarje, midis studentëve të këtij programi. Rregulloret e brendshme përcaktojnë edhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Më specifikisht kjo është detajuar edhe në syllabuset e secilës lëndë. Procesi i zhvillimit të sezonit të provimit, promovimi dhe kontrolli i dijeve, dokumenti i vlerësimit të studentit si dhe e drejta e përmirësimit të notave janë pjesë e rëndësishme në rregulloren e ciklit të dytë të studimit.</p> <p>Provimet janë të sekretuara dhe pas nxjerrjes së rezultateve, studentët kanë mundësinë të marrin sqarime nga pedagogët lidhur me procesin e vlerësimit. Në rast se studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin ai ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda ditës së shpalljes së rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura. Nëse verifikohet gabim i korigjueshëm nga përgjegjësi i departamentit, në bashkeveprim me komisionin e provimit realizohet korigjimi. Kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vihet në dijeni Dekanin, i cili nga pasja e dijenisë për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose mund të marrë vendim për rizhvillim të provimit (<i>Evidenca, III.13</i>).</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se, Albanian University, përmbush plotësisht standartin V.5, për arsye se përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së, në Albanian University, konstatohet se ky institucion në shërbim të informimit të studentëve, por edhe përputhje me aktet ligjore dhe rregullatore të tij, gjendet zyra e Informimit të Studentëve, të Karrierës dhe Alumni, e cila kategorizohet si njësi ndihmëse në funksion të institucionit.</p> <p>Institucioni posedon njësi të posaçme të informimit e shërbimit të studentëve. Këto struktura janë institucionale si Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët (Tutoriati & Mentorimi), Sekretaritë, Zyra e IT, Zyra e financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët vënë në dispozicion të studentit rubrikën e transparencës, sipas një programi online të miratuar më parë (https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/studenti/).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Albanian University, ka funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët (Tutoriati & Mentorimi) (https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/studenti/). Me anë të komunikimit direkt (PTIAGORA) por edhe të platformave komunikimi të zhvilluara brenda universitetit me studentin, stafi akademik informon dhe informohet për procesin mësimor, mungesat apo vlerësimin teorik apo praktik të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me</p>	<p>Në bashkëpunim me këshilluesit e karrierës së çdo njësie bazë dhe kryesore, në bashkëpunim me zyrën e informimit të studentëve, të këshillimit dhe karrierës, dhe Alumni, zhvillojnë takime dhe aktivitete për çështje të ndryshme në këtë fushë.</p> <p>Albanian University, ka njësi të posaçme të informimit e shërbimit të studentëve siç janë Sekretaritë, Zyra e IT, Zyra e financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët (Tutoriati & Mentorimi), Zyrën e karrierës dhe Almunit (<i>Evidenca, V.4.a</i>).</p>

kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjatë vizitës së GVJ-së në Albanian University dhe takimit me studentët, konstatohet se të gjithë studentët ishin të informuar, të familjarizuar dhe orientuar për çështje të ndryshme nga kjo zyrë. Gjithashtu, studentët ishin të orientuar të zhvillonin praktikat mësimore ose intervista pune, me orientimin e kësaj zyre dhe stafit akademik të njësisë bazë, në institucionet ku Albanian University, ka marrëveshje ose me zgjedhjet e tyre preferenciale (https://albanianuniversity.edu.al/sq/udhezuesi-i-karrieres/).			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Albanian University, zotëron , zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët (Tutoriati & Mentorimi), Zyrën e Karrierës dhe Almunit, të cilat asistojnë në gjurmimin e studentëve (Evidenca, V.4.a). Këto njësi kanë formuar një databazë të të dhënave të gjurimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se, Albanian University, përmbush plotësisht standartin V.6, për arsye se zotëron procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Albanian University ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies që lidhen me mësimin në distancë.</p> <p>Konstatohet se gjatë vizitës në GVJ-së, në Albanian University, mësimdhënia shoqërohet edhe me strukturimin e ambienteve sipas kriterëve të programit dhe departamentit, në ambientet fizike. Përdorimi metodave të ndryshme bashkëkohore sipas moduleve të lëndëve specifike të programit (siç janë lëndët pedagogjike), bashkojnë përvojë shumëvjeçare të institucionit me metodikat moderne të përfituara gjatë kualifikimit të stafit ndër vite (<i>Evidenca, VI.4</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Njësia bazë, e cila së bashku me njësinë kryesore dhe në bashkëpunim me NJSCB, zhvillojnë monitorime dhe vlerësojnë aftësitë e mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmës akademik, nëpërmjet formularit të performancës. Duke mos cënuar lirinë akademike, monitorimi i stafit në ambientet fizike ku zhvillohen orët mësimore (duke marrë parasysh specifikat e lëndës), me kërkesën për përmirësim nga studentët, mund të vlerësohet nga një grup i ngritur nga njësia bazë (<i>Evidenca, VI.4</i>).</p> <p>Albanian University, nëpërmjet Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësoin e studentëve për matjen e performances, në cdo fillim sezoni të provimeve, për cdo semester. Të dhënat publikohen me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,</p>	<p>Albanian University, nëpërmjet Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësoin e studentëve për matjen e performances, në cdo fillim sezoni të provimeve, për cdo semester (<i>Evidenca, VI.4</i>). Të dhënat publikohen me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet.</p>

përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	<p>Nga të dhënat e këtij formulari, njësia bazë dhe kryesore vihet në dijeni dhe merren masa për vazhdimësinë proceduriale (<i>Evidenca, III,8</i>).</p> <p>Nga vizita e GVJ-së, zhvilluar në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes, gjatë takimit me studentët, kostatohet së studentët, jo vetëm nëpërmjet formati të vlerësimit periodik të stafit akademik, por edhe për çdo pakënaqësi që mund të kenë, ndihen të lirshëm ta diskutojnë me lektorin e lëndës dhe me drejtuesin e njësive bazë.</p>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Albanian University ka funksional Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorin e studentëve për matjen e performances së stafit akademik dhe administrativ, dy herë në vit, në periudhën e sezonit të provimeve. Pyetësorët ofrohen nëpërmjet platformës Microsoft Team, dhe pas analizimit të të dhënave, dërgohen të njësive baze, njësive kryesore dhe në dijeni të hierarkisë të institucionit (<i>Evidenca, III,7, a</i>).</p>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Albanian University, nëpërmjet rezultateve dhe vlerësimit të pyetësorëve të organizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, promovon shembuj të praktikave të mira dhe nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p> <p>Gjithashtu, praktikat e shkëmbimeve të stafit akademik, të ofruara nga projekte dhe marrëveshje të ndryshme, u jep mundësi atyre në përfitimin e përvojave të reja dhe të ndryshme, si dhe reflektimin e tyre gjatë mësimdhënies në këtë institucion.</p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.1 përmbushet plotësisht, ku Albanian University, ndjek politika të qarta për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë mbetet kërkesë themelore e Albanian University, për rritjen e reputacionit brenda dhe jashtë vendit, duke u bazuar në aktet dhe nënaktet ligjore të arsimit të lartë “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në ILA, në Republikën e Shqipërisë”. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës. Të dhënat publikohen me qëllim transparence të rezultateve dhe rekomandimeve. Pyetësorët realizohen dy herë në vit, para fillimit të çdo sezoni të provimeve. Kjo procedurë realizohet nëpërmjet urdhërave të posaçëm që paraqiten si në evidencën e poshtëshënuar.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Albanian University, zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Institucioni angazhon edhe personelin akademik të ftuar, të angazhuar në mësimdhënie, personalitete nga brenda dhe jashtë vendit, për rritjen e cilësisë.</p> <p>Sipas Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2017-2022, dhe Plani Strategjik Institucional 2023-2028, zbatimi i strategjive së rritjes së cilësisë së brendshme, është e vazhdueshme për tu përgjigjur kërkesave të aktualitetit.</p> <p>Në zbatim të legjisllacionit dhe bazës rregullatore të ndërtuar nga vetë Albanian University, Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet); • Zyra e NJSBC • Njësia kryesore dhe bazë, etj (<i>Evidenca, I.2.a</i>) <p>Konstatohet se gjatë vizitës së GVJ-së, në institucion, plani zbatohet në dukje me diversitet modelesh, metodash etj, gjatë procesit të mësimdhënies, në formulimin e kurrikulave si dhe në aktivitetet e ndryshme me profil peagogjik dhe menaxhim në arsim. Për këtë promovohet mësimi e krijimtaria përmes angazhimit në punë praktike konkrete (praktika mësimore)</p>



	qëllim arritjen e zhvillimit të vazhdueshëm profesionale (<i>Evidenca, I.2.b</i>).			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	<p>Albanian University, mundëson realizimin e sigurimit të jashtëm të cilësisë sipas kriterëve të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL, si dhe kriteret akademike për të zhvilluar edhe përmirësuar nivelin e edukimit. Institucioni këshillohet edhe me vlerësuesit e jashtëm, në kuadër të rritjes së cilësisë (<i>Evidenca:III.9</i>).</p> <p>Nëpërmjet vizitës në institucion, GVJ konsaton se, në fillim të çdo semestri, institucioni ofron trajnime me tematika të ndryshme në fushën e mësimdhënies, menaxhimit, teknologjisë etj, që ofrohen nga akademik të specializuar në fushat specifike.</p>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	<p>NJSBC në Albanian University ka në fokus ndërgjegjësimin e personelit akademik, ndihmësmësimor dhe të studentëve që ndjekin programet e studimit të ofruara, për rëndësinë e cilësisë se programeve të studimit si dhe për sigurimin e cilësisë së tyre. NJSBC harton raporte në mënyrë periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, të cilat përdoren si burim për vlerësimet e brendëshme dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Raportet përfshihen në analizën vjetore të Senatit Akademik, ku vlerësohen për promovime nxitëse dhe përmirësime (analiza swot) të ndryshme në programet e studimit, të njëjësive bazë.</p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.2 përmbushet plotësisht, sepse Albanian University, harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Albanian University, nëpërmjet Planit Strategjik sntitucional të 2023-2028, paraqet strategji dhe politika për përmirësimin e procesit akademik të programeve të studimit.</p> <p>Edukimi në këtë institucion përmbush këto detyrime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimin e programeve të studimit; • Forcimin e orientimit drejt studentëve dhe tregut; • Zhvillimi i praktikave të reja të edukimit; • Sigurimin e infrastrukturës së mësimin dhe asaj organizative; • Forcimin e kompetencave akademike, profesionale, sociale dhe etike të edukimit. <p>NJSBC e Albanian University, ka hartuar dhe vënë në përdorim mekanizma e instrumenta për mbikqyrjen e ecurisë të programit të ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" (<i>Evidenca, VI.3.b</i>). Përkatësisht ky pyetësor synon të grumbullojë vlerësimet nga student, lidhur me nivelin e përmbajtjes së lëndëve, elementet praktik dhe profesional si dhe ndërdisiplinore që ofron programi i studimit që ndjekin, cilësinë e mësimdhënies dhe didaktika/metodologjia e saj, larmishmërinë e llojeve të materialeve për mësimdhënie, angazhimin e stafit akademik dhe gatishmërinë e tyre në ndihmë të studentëve, lidhjen midis studentëve dhe stafit; mjediset dhe infrastruktura që ofrohet nga institucioni.</p> <p>Nisur nga vizita e GVJ-së në këtë institucion, konstatohet se programi i studimit të ciklit të dytë, janë të mirëorganizuar, sipas akteve ligjore, me lëndët specifike modern të profesionit, orientimin e studentëve në tregun e punës nëpërmjet marrëveshjeve të realizuara në nivel institucional, si dhe në përfshirjen e studentëve në programe dhe veprimtaritë akademike.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Albanian University, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët (Tutoriat & Mentorimi), si dhe Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë,</p>



<p>prishme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>nëpërmjet komisionit të ngritur në fakultet, zhvillojnë takime dhe diskutime të shpeshta me studentët, për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së procesit mësimor (<i>Evidenca, VI.11</i>).</p> <p>Gjithashtu, analizat vjetore të njëjësive bazë dhe raportet periodike të NJSBC përfshijnë rezultatet e marra dhe shprehin edhe rekomandime për të përmbushur kërkesat e studentëve, lidhur me aspektet e përmirësimit të te proceseseve të mësimdhënies dhe nxënies (https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-koordinimit-dhe-mbeshetjetes-ndaj-studentit/)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Si garantues i cilësisë është kryesore njësi bazë, me përgjegjësin e departamentit për vlerësimin e secilit pedagogë të lëndëve. Në “formular për vlerësimin e pedagogut nga eprori-kolegu” jepen disa kritere që vlerësohen sipas renditjes nga shumë mirë, mirë, pjesërisht dhe dobët. Nëpërmjet këtij formulari, vlerësohet organizimi dhe qartësia, si edhe komunikimi me studentët.</p> <p>Ndërsa nëpërmjet formularit që studentët vlerësojnë pedagogun, përpara sezonit të provimeve (për të mos pasur konflikt interesi), maten elementët e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimet objektive të lektorit ndaj studentit, komunikimi, entuziazmi, mënyra e përdorimit të referencave bashkëkohore dhe të dobishme për studentët, zotërimin e njohurive dhe përdorimin e tyre me efikasitet në auditor etj.</p> <p>Gjithashtu, nga vizita e GVJ-së në Albanian University, konstatohet se, praktikat akademike të përdorura për përgatitjen e studentëve, mundëson aftësinë e studentëve për të qenë specialist në disiplinën e edukimit dhe menaxhimit të arsimit në tregun e punës në Shqipëri. Institucioni, në kuadër të vlerësimit, të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda bashkëkohore. Vlerësimi i të nxënësve, vlerësimet në provime dhe kryerjes së praktikave, të paraqitura në analizën vjetore të departamentit (<i>Evidenca, III.5</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta</p>	<p>Albanian University, vlerëson veprimtarinë akademike për cilësinë e saj, nëpërmjet pyetësorëve me studentët për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Marrja e vlerësimeve nga studentët realizohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetësorëve me studentët e programit të studimit; • Pyetësorëve rreth vlerësimit të didaktikës dhe kurikulës;



<p>vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Si dhe intervista në formë bisedash midis stafit përgjegjes (në pjesën më të madhe shefit të departamentit). <p>Gjithashtu, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore përdor në kuadër të vlerësimit, të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit metoda të tërthorta: sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve, sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të mësuarit, pyetje konceptuale, intervista etj. (<i>Evidenca, III.4</i>)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në gjetjet dhe arkivat e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.3 përmbushet plotësisht, ku Albanian University, monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëni.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësiti akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin</p>	<p>Albanian University, nëpërmjet Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ofron mundësinë për garantimin e cilësisë së tij dhe programeve të studimit. Ky njësi përbëhet nga komisione me anëtarë në secilin fakultet si dhe një përfaqësues nga studentët. Fakulteti i Shkencave Shoqërore, parashikon garantimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë nëpërmjet krijimit të njësive për sigurimin e brendshëm të cilësisë për çdo program studimi që ajo ofron. Kjo realizohet</p>

<p>e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>duke ngritur grupet e punës për sigurimin e brendshëm të cilësisë si në rastin aktual në kuadër të procesit të akreditimit të programeve. Grupet e jashtme të vlerësimit gjatë këtij procesi bëjnë të mundur mbikqyrjen dhe garantimin e cilësisë së programit të studimit në veçanti, dhe institucional në tërësi (<i>Evidenca, VI.9</i>).</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në institucion, konstatohet se komisioni dhe grupet e punës, kanë funksionuar për të mundësuar vazhdimësinë e cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Albanian University, përcakton organizimin dhe funksionimin, si dhe detyrat konkrete dhe përgjegjësitë e anëtarët e komisionit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në Statut dhe në Rregullore.</p> <p>Institucioni ka të përcaktuar në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të saj detyrat konkrete për njësinë (<i>Evidenca, I.5</i>).</p> <p>Dekanati me anë të vendimeve të posaçme përcakton detyrat për njësitë e sigurimit të cilësisë së brendshme, anëtarët përberës së këtyre grupeve si personel akademik, ndihmës dhe studentë. Departamenti përkatës koordinon dhe mbikqyr grupin e punës.</p> <p>Ndërkohë në garantimin e sigurimit të cilësisë së brendshme, dhe cilësisë së mbarëvajtjes së programeve të studimit në ciklin e parë dhe të dytë, specifikisht në programin aktual, një rol shumë të rëndësishëm luajnë njësia bazë, njësia kryesore edhe njësi të tjera (si sekretaria mësimore etj) (<i>Evidenca, VI.9</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në Albanian University, Dekanatit i Fakultetit të Shkencave Shoqërore, nëpërmjet vendimet, parashikohet dhe garantohet përfshirja e të gjitha njësive bazë dhe atyre kryesore si dhe përcaktohen anëtarët, përgjegjësitë dhe detyrat e tyre në keto grupe (<i>Evidenca, VI.3.a</i>).</p> <p>Gjithashtu, departamenti i propozon dekanit kordinatorin dhe grupin e punës për vlerësimin e brendshëm të programit të studimit.</p> <p>Nga vizita në institucion e GVJ-së konstatohet se në këto grupe pune ishin përfshirë anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe një student.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të</p>	<p>Albanian University, ka procedura të vlerësimit të brendshëm i cili i nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar. Përcaktimi i</p>



<p>brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>grupeve të punës së vlerësimit të brendshëm bëhet në përputhje me të drejtën e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së të gjitha palëve të interesuara, të personelit akademik me njohuritë dhe ekspertizën e duhur në fushën specifike të programit të studimit dhe një përfaqësues student të atij programi studimi, që garanton dhe kryerjen objektive të vlerësimit. Studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit. Studentët mbështeten, dëgjohen kërkesat apo sugjerimet e tyre për t'u përfaqësuar në proceset e vlerësimit (<i>Evidence, VI.10</i>).</p> <p>Ky proces parandalon diskriminimet ose pabarazitë, si dhe mundëson integritet të gjithë pjesëtarëve të tjerë që plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e këtij grupi.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, ka si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë profil studimi me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë dhe sugjerime, në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> <p>Albanian University, ka marrëveshje me institucione të tjera të ngjashme dhe fton bashkëpunëtorë dhe pedagogë nga këto institucione. Pedagogët e ftuar nga këto universitete japin kontributin e tyre për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përshtatjen dhe zhvillimin e programeve lëndore si dhe ofrojnë ekspertizën e tyre për ruajtjen dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë së programit përkatës të studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në gjetjet dhe arkivat e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri VI.4 përmbushet plotësisht, ku Albanian University përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Baza rregullatore që ka hartuar Albanian University, për sigurimin e brendshëm të cilësisë përfshin ndër të tjera edhe këto dokumente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; ▪ Statuti; ▪ Rregullorja e institucionit. <p>Një pjesë e dokumentacioni është publike siç janë statuti, rregulloret dhe veprimtaritë, ku të gjithë studentët mund ta marrin nga departamenti, zyra e studenteti, dhe faqja zyrtare online etj).</p> <p>Në këtë institucion gjendet dhe funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucional për matjen e performancës. Të dhënat publikohen me qëllim transparencën dhe arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet</p> <p><i>(https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/universiteti/)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Të dhënat e realizuara si rezultat i pyetësorëve institucional publikohen me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet Informacioni nga monitorimi i njësive të ndryshme, shkon te rektorati, dekanët dhe shefat e departamenteve (duhet të rikujtohet se në këtë institucion egziston edhe komunikim i shpejt joformal, për zgjidhjen sa më shpejt të problemeve). Gjatë hartimit të raportit respektohet liria dhe etika akademike, në përputhje me parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi (<i>Evidenca, VI.11</i>).</p> <p>Gjatë vizitës të GVJ-së, në dosjet e personelit akademik, gjendeshin dokumentacione të plota të detajuara, përfshirë edhe vlerësimi më i fundit i stafit i përfshirë në dosje.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Albanian University, konstatohet se rezultatet nga pyetësorët e vlerësimit, diskutohen në njësinë bazë dhe kryesore për të nxjerrë një plan masash veprimi për ndryshimin e pikave që mund të jenë të dobëta. Të dhënat nga pyetësorët vetë-vlerësues shfrytëzohen edhe për të bërë krahasime në periudha kohore si dhe për të bërë vlerësim të</p>

<p>mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>performacës. Plani i punës dhe raportet mujore e semestrale të NJSBC po ashtu japin rekomandime të cilat i paraqiten Rektoratit të Albanian University, i cili më pas ndërmerri hapa për të trajtuar dhe zgjidhur problematikat (<i>Evidenca, VI.9</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ-së në Albanian University, konstatohet se sigurimi i cilësisë bazohet në disa hallka të kontrollit dhe disa nivele të zhvillimit siç janë kontrolli nga drejtuesit e departamentit kordinatori i programit, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë etj (<i>Evidenca, VI.9</i>).</p> <p>Për përmirësimin dhe zhvillimin e njësisë bazë, instiucioni monitoron dhe mbështet financiarisht dhe me infrastrukturën e nevojëshme grupet e vlerësimit të brendshëm dhe kërkesat që ata parashtrojnë për të përmirësuar cilësinë e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Albanian University, nëpërmjet bashkëpunimit me projektet e ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare, u jep mundësinë stafit akademik, administrative dhe studentëve të ndjekin trajnime, ëorkshop, leksione të hapura etj. të cilësisë me standarte ndërkombëtare.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në institucion vihet re se njësia bazë, mundëson orientime për përmirësimin e sigurisë, specifikisht për programin e studimit të nivelit të dytë. Institucioni zhvillon takime periodike informuese dhe me diskutime të hapura për studentët sipas cikleve të studimit ku informohen për veprimtarite në funksion të përmirësimit të cilësisë, për kërkesat lidhur me infrastrukturën dhe transparencën financiare, takimet për zhvillimin e praktikave profesionale, takimet me fokus grupet për diskutim dhe informim mbi proceset e vlerësimit dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit që ata ndjekin.</p> <p>Gjithashtu, analizat vjetore të departamentit paraqet informacionin përkatës si dhe planin e masave për sigurimin e përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në gjetjet dhe arkivat e evidentuara më sipër, GVJ vlerëson se kriteri V.5 përmbushet plotësisht, ku Albanian University, nëpërmjet politikave, proceseve dhe veprimtarive për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit 'Master Profesional në Pedagogji, me profil 'Mësuesi në Arsim Fillor' dhe 'Menaxhim Arsimi' janë publike, transparente e</i></p>

	<i>efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Pedagogji” me profil 1. “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe 2. “Menaxhim Arsimi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Albanian University”

Pikat e forta dhe afirmime

- Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil 1. “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe 2. “Menaxhim Arsimi” është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe me aktet rregullatore në fuqi, dokumentet rregullatore të “Albanian University” dhe në përshtatje të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.
- Programi i studimit ka një kurrikul të hartuar dhe të riorganizuar me kujdes për t’iu përgjigjur kërkesave dhe standardeve bashkëkohore në fushën e mësuesisë.
- Programi i studimit, është i hartuar për të përgatitur studentë në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar.
- Staf i akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në këtë program studimi, përbëhet nga ekspertë të fushës me një eksperiencë të gjatë në mësimdhënie si dhe zotëron kualifikimet e duhura me tituj dhe grada për zhvillimin me cilësi të tij.
- Ndërthurja e orëve në auditor me orët e praktikave profesionale në shkolla dhe angazhimi i studentëve në punën dhe kërkimin shkencor siguron një përgatitje profesionale dhe akademike të kënaqshme për studentët e mësuesisë.

Pika të dobëta

- Zgjerimi i parneritetit ndërkombëtar (*Standardi I.3, Kriteri 2*)
- Mospërfshirja e literaturës së 5 viteve të fundit në një pjesë të syllabuseve lëndore të këtij program studimi (*Kriteri II.4.5*).

Rekomandime

- Rekomandojmë që DEA të ofrojë trajnime për mësuesit dhe për studentët e degës së mësuesisë (*Standardi I.2, Kriteri 5*).
- Rekomandojmë zgjerim të parneritetit ndërkombëtar (*Standardi I.3, Kriteri 2*)
- Rekomandojmë përditësim të një pjese të syllabuseve lëndore me literaturë të 5 viteve të fundit (*Kriteri II.4.5*).
- Sugjerojmë që për të dy profilet e programit të studimit, lënda “Metodat e kërkimi shkencor” nga lëndë me zgjedhje të vendoset lëndë e detyruar (*Kriteri II.4.6*).



Evaluation's conclusions for the second cycle study Professional Master in Pedagogy Program with a profile in "Primary Education" and "Educational Management" provided by the Higher Education Institution "Albanian University"

Strengths and affirmations

- The Professional Master's study program in "Pedagogy" with profile 1. "Teacher in Primary Education" and 2. "Educational Management" is designed by the Law on Higher Education and with the regulatory acts in force, the regulatory documents of the "Albanian University" and in full alignment with the academic field of the Faculty of Social Sciences and the Department of Education and English.
- The study program has a carefully designed and reorganized curriculum to respond to contemporary requirements and standards in the field of teaching.
- The study program is designed to prepare students for the domestic and international market.
- The effective and contracted academic staff engaged in this study program consists of experts in the field with a long experience in teaching as well as possessing the appropriate qualifications with titles and degrees for quality development.
- The combination of hours in the auditorium with hours of professional practices in schools and the engagement of students in work and scientific research ensures satisfactory professional and academic preparation for teaching students.

Weaknesses

- Expansion of international partnership (Standard I.3, Criteria 2)
- The non-inclusion of the literature of the last 5 years in a part of the subject syllabi of this study program (Standard 2, Criteria 4.5).

Recommendation

- Experts recommend that the Department of Education and English, to get provide training for teachers and teaching students (Standard I.2, Criterion 5).
- Experts recommend expansion of international partnership (Standard I.3, Criterion 2)
- Experts recommend updating part of the subject syllabi with literature from the last 5 years (Criterion II.4.5)
- Experts recommend that for both profiles of the study program, the subject "Methods of scientific research" from an optional subject to a compulsory subject (Criterion II.4.6).

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'R. Vajta', is located in the bottom right corner of the page.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

